ISSN 1857-6443

## MOTI I KEQ

Kaos në Shkup



Fq.3

## “SOPOTIT” DHE “MONSTRA”

Do të kërkohet përgjegjësi penale për skenaristët



Fq.4

## Iu dha lamtumira e fundit Fadil Vokrrit



Fq.12


# Koha

www.koha.mk





KOHA për sport

Fq.12-14

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3386 · E hënë, 11 qershor 2018 · 15°c |20°c · 15 DEN

EDITORIAL

## Guximi për të qenë bandit



Një qytetar ka kërcënuar me jetë kryetarin e Gostivarit dhe derisa po e shkruajmë këtë editorial nuk e dimë nëse kërcënuesi është arrestuar ende. Këta banditë që guxojnë të kërcënojnë hapur një përfaqësues legal e legjitim të pushtetit vendor, duhet të jenë shumë kokëshkretë, në tentativat e tyre për të zbatuar ligjin e xhunglës...

Fq.2

KRONIKË

## Kërcënohet me jetë Arben Taravari nga Hebib Fejzuli

Fq.9

MALI

## Boko Haram vret një shqiptar nga Tetova

Fq.9



### PROPOZIM LIGJI I RI PËR FATURAT E PAPAGUARA

# A DO TË SHLYHEN KAMATAT NGA BORXHET E VJETRA?



**Mbi 200 mijë qytetarë që vazhdojnë të kenë të bllokuara llogaritë bankare nga ana e përmbaruesve për shkak të mos pagesë së borxheve të mbetura të faturave energjetike, ujit, bërllokut, faturave ndaj operatorëve të telefonisë fikse dhe celulare si dhe operatorëve kabllovikë, me miratimin e propozim ligjit të ri për shlyerjen borxheve dorëzuar nga partia opozitare VMRO do të lirohen nga pagesa e kamatave të borxheve të vjetra më shumë se 10 vite dhe do të mund të paguajnë vetëm borxhin bazë**

Fq.4

## 19 vjet nga kapitullimi i Serbisë

Sekretari i përgjithshëm i NATO-së, Javier Solana, më 10 qershor 1999 kishte lëshuar urdhrin për ndalimin e bombardimeve, kurse Këshilli i Sigurimit të OKB-së, po në të njëjtën ditë, kishte miratuar rezolutën 1244, ku u dërguan 37.200 ushtarë të KFOR-it nga 36 shtete. Më 12 qershor të vitit 1999, në Kosovë kanë zbarkuar trupat e para të këmbësorisë së NATO-s, ndërsa ka nisur largimi i forcave serbe. Misioni ishte i ndarë në pesë zona të përgjegjësisë, që i përkisnin KFOR-it Amerikan, Anglez, Francez, Gjerman dhe Italian.

Me hyrjen e NATO-s, në Kosovë ka nisur edhe vendosja e misionit të përkohshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili do të administronte vendin për një periudhë të caktuar kohore.

Në të njëjtën kohë, është shpërbërë edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, për t'u shndërruar në Trupat Mbrojtëse të Kosovës.



EDITORIAL

# GUXIMI PËR TË QENË BANDIT



Emin AZEMI

Një qytetar ka kërcënuar me jetë kryetarin e Gostivarit dhe derisa po e shkruajmë këtë editorial nuk e dimë nëse kërcënuesi është arrestuar ende. Këta banditë që guxojnë të kërcënojnë hapur një përfaqësues legal e legjitim të pushtetit vendor, duhet të jenë shumë kokëshkretë, në tentativat e tyre për të zbatuar ligjin e xhunglës, ose duhet të jenë shumë të sigurt se veprimet e tilla mbeten të pandëshkuara. Qytetarët e Gostivarit nuk e meritojnë të dhunohen nga individë të fortë, vetëm për faktin se ata fuqinë e bazojnë mbi indiferencën e shtetit për të mos vepruar. Nuk është vetëm Gostivari që vuan pasojat e banditizmave të individëve, të cilët (pa)rëndësinë e tyre shoqërore mundohen ta veshin me arrogancën e njeriut që i duket vetja më i madh se mbreti. Zakonisht cak sulmi i banditëve të tillë janë njerëzit e urtë e të ndershëm, të cilët me punën dhe disiplinën e tyre dëshmojnë një trohë integritet profesional e qytetar në këtë shoqëri. Por, ja që banditët nuk pyesin për integritet dhe qytetari. Ata duan të imponojnë normat e tyre të sjelljes dhe të gjithë të tjerët duhet t'iu nënshtrohen atyre normave. Nëse ndodhë që të kundërshtosh, të respektosh ligjin, automatikisht je bërë armik i banditëve.

Kokëqethurit e lagjeve tona, të zaptuara me bërllok e prapambeturi sociale, e kanë mësuar fshehtësinë e të qenit kapadai. Ata duken nja dy, tri ditë nëpër shtabet partiake gjatë zgjedhjeve, bëhen sikur po ndihmojnë dhe pastaj katër vjet duhesh të bëhesh peng i arrogancës së tyre. Për katër vjet, ata aktrojnë turli bodiguardi, turli shoferi e turli eminence gri. I ke gjithkund, nëpër restorante të shtrenjta, ulur në xhipa luksozë dhe me gishtin e futur thellë në hundë shpesh shfletojnë smartfonët për të ndjekur nga afër "mëhallën e budallenjëve" dhe për tu bërë pastaj komentues të zjarrtë të temave që s'i marrin vesh.

Nuk ndodhë të ndahet ndonjë tender, të caktohet ndonjë tokë ndërtimi, të shpallet ndonjë konkurs, ku nuk e ke prezent ndikimin direkt apo indirekt të këtyre kokëqethurve. Shoqëria jonë është mbushur me zgjatime të tilla kriminale që i japin ritëm të mjerë jetës sonë të përditshme dhe sot e ke vështirë të bësh dallimin në mes të biznismenit të ndershëm dhe diler-matrapazit, në mes të pedagogut idealist dhe fiqfiriqit dhëmbë pa larë, që pajiset me diplomë fakulteti në moshën 50 vjeçare, në mes të teologut model dhe sehirbazit etj.

Të jesh bandit sot, nuk duhesh të plotësosh shumë kushte. Mjafton të ndjekësh trendet shoqërore, ku vlerat kanë rënë përtokë, të qerasësh ndonjë njeri të pushtetit, dhe mundësisht të kesh sa më pak vite të mbaruara të shkollës fillore. Sot te një ministër më lehtë depërton kjo kategori njerëzish, se sa një intelektual. Jo se të gjithë ministrat bëhen të lumtur kur shohin në kabinetet e tyre këto faca, por këta të fundit gjejnë mënyra e udhë për të depërtu brenda një kohe të shkurtër, ndërkohë që një intelektuali i nevojitet një vit përpjekjesh. Këto mund edhe të faktohen nëse e kërkon dikush.

Profili psikologjik e social i banditit të sotëm ka filluar ta lë nën hije gatishmërinë e shoqërisë për tu ballafaquar me këto fenomene negative, kurse shteti vazhdon të "hulumtojë" rrethanat e kërcënimit ndaj kryetarit të Gostivarit. Nëse banditët e tillë sot nuk futen prapa hekurave, nesër ata mund të kidnapojnë edhe ndonjë ministër, për të kërkuar në këmbim të lirimit dinjitetin tonë kolektiv si shoqëri që jemi mësuar të heshtim si strucët edhe atëherë kur na e rrasin në sy atë gishtin e palarë që banditët e përdorin për të eksploruar hundët e tyre lapidare.



**A PO MUND GJENI NAJSEND, O HALIL?"**

"Kur Haradinaj pati marrë hyxhym me ngajte naper shesh, Halil Matoshi pati dalë me kunderargument. E pati postu nje foto te Obamas, duke vrapuar.
Sigurisht, në keto momente Halili dhe keshilltarët e tjerë të Haradinajt, janë duke kërkuar argumente për ta minimizuar gjestin e sotem të kryeministrit. Janë duke bërë search në google me fjalinë "Obama duke e ngrehe zhag prej foltores nje grua".
A po mund gjeni najsend, o Halil?", ka komentuar gazetari Parim Orulli sjelljen skandaloze të Ramush haradinajt teksa largoi me forcë mbesën e Mehmet Derallës nga foltorja e ceremonisë në Prizren



**LUFTA PËR TË GJETUR NËNSHTRUESIN**

"Kur NATO e largoi Serbinë nga Kosova, në qershor të vitit 1999, shumica e popullit shqiptar përbëhej nga njerëz të nënshtruar ndaj regjimit serb dhe, këta të nënshtruar, mezi pritën të gjejnë nënshtruesin, pa marrë parasysh cili ishte ai, nga Lindja a Perëndimi, apo edhe nga njerëz brenda Kosovës, të ashtuquajtur "njerëz të vet", sepse një jetë kishin bërë një jetë të tillë. Pra, nuk mund ta mendonin të jetuarit pa iu nënshtruar dikujt!
Dhe ish-të nënshtruarit që kërkojnë me qiri e me pishë nënshtrues, kur në të katër anët gjenden të tillë, para se të krijojnë jetë kualitative, krijojnë kaos, ku nuk e njeh qeni të zonë!
Edhe lufta që bëjnë në mes veti këta ish-të nënshtruar, duke u kacafytur disa "pro" Lindjes, e disa "pro" Perëndimit, e disa "pro" dreqit e të birit, para se ta ketë bazën te çështjet materiale apo ato ideale, e ka bazën psikike, pra në gjetjen me çdo kusht të nënshtruesit, pa të cilin nuk mund të jetojnë.
Këta janë në gjendje edhe të kacafyten në mesvete për atë se cili nënshtrues është më i mirë, më i fortë apo më human, pra janë në gjendje t'ia thyejnë kokën njëri-tjetrit duke luftuar për kauzën e nënshtruesve të tyre!", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, studiuesi nga Prishtina, Sali Bytyçi.



**KUJT T'IA JEPNI FITRAT!**

"Megjithëqë Islami ka paraparë 8 kategori njerëzish të cilëve u takojnë fitrat, sot, pa pikë dyshimi Medresja dhe institucionet arsimore fetare islame janë më të nevojshmet për zekatin dhe fitrat.
Miq të nderuar!
Mos i shpërndani fitrat tjera kah. Nëse i shpërndani, gaboni. Jepni vetëm për Medrese me fletpagesa (blloka) të Bashkësisë Islame...
Allahu ua pranofta agjërimin, fitrat e zekatin dhe krejt punët e hajrit që i bëni...!", ka sqaruar përmes një statusi në Facebook, teologu Mustafa Bajrami.

MEDIACitate

## 'RAMBUJE E DYTË' PËR ZGJIDHJEN KOSOVË-SERBI

Konferenca ndërkombëtare e nivelit të lartë që në të vërtetë do të përfaqësohej si një Rambuje e dytë, mund të mbahet në një shtet të perëndimit me qëndrim neutral si Zvicra. Nga fuqitë e mëdha botërore pritet të diskutohen rrugët për të normalizuar raportet e plota ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, dhe këtu do të mund të krahasonim situatën me negociatatat në Rambuje. Edhe pse qeveria e Serbisë preferon që kjo të jetë një lloj Marrëveshja e Daytonit, pasi nga një marrëveshje e tillë doli Republika Srpska në Bosnje. Sidoqoftë vetë Vuçiqi, preferon që zgjidhja të arrihej në një format më të gjerë, sesa në zyrën e Brukselit.
Gjermanët kanë vërejtje të shumta në punën e Mogherinit dhe Johanes Hahn në dialogun me Serbinë. Sipas bashkëbiseduesve tanë të mirë-informuar në Berlin ende nuk kanë dhënë ndonjë ide për të dërguar të posaçëm, i cili do të ishte përgjegjës për formën e dialogut. Zgjedhja do të ishte në ndonjë ish-zyrtar gjerman që respektohet në Berlin, Bruksel, Uashington dhe Moskë", shkruan kjo gazetë.
Shkas për idenë e një konference si të Rambujesë ka qenë takimi i fundit në Nju Jjork. Me sa duket çelësi për zgjidhjen e problemeve me Kosovën është në duar e amerikanëve", citohen këto burime. Ndryshe nga gjermanët të cilët ende mendojnë se ndarja e Kosovës është e papranueshme, por besojnë se Kosovës duhet t'i jepet një vend në OKB. Amerikanët besojnë se, zgjidhja që Serbia ta merr veriun e Kosovës dhe të gjitha Masnastret nuk është e papranueshme", thuhet tutje.
Tani të gjithë sytë e botës janë në Amerikën. Në këtë kontekst është e qartë se vendet e BE-së po tentojnë ta diskreditojnë dialogun në Bruksel, për t'i hapur rrugë organizimit të një konference të madhe ndërkombëtare për Kosovën
Në fund negociatat dështuan pasi marrëveshja ushtarake nuk u pranua dhe Serbia u bombardua. Pra për të shmangur gabimet e tilla është e nevojme që këtë herë asnjëra palë të mos jetë në presion. Pra Beogradi të mos sulmohej duke thënë se do të bllokohej në rrugën drejt BE-së, dhe ky takim do të ishte mirë të mbahet jo vetëm për Kosovën, por për gjithë Ballkanin Perëndimor.
Dialogu në nivelin e lartë pritet të vazhdojë në fundin e muajit qershor. Kjo ishte konfirmuar edhe nga presidenti serb, Aleksandar Vuçiq.
Ndryshe presidenti Thaçi, ditë më parë ka paralajmëruar se në zgjidhjen me Serbinë do të ketë kompromise të dhimbshme.

*(Danas, 10 qershor)*

NËSE NUK E KENI DITUR...

## A E DINI SE NGA E KA ORIGJINËN HALLVA?

Fakte mbi ëmbëlsirën e popullarizuar hallvë Fakte mbi ëmbëlsirën e popullarizuar hallvë Hallvë është një prej ëmbëlsirave më të popullarizuara edhe në vendin tonë. Ajo gatuhet për raste të ndryshme, veçanërisht për Netët e Mëdha të fesë islame, por edhe për raste mortore, shkruan rtv21. Po ashtu në popull dihet se hallvë bëjmë edhe kur një person i caktuar i shpëton ndonjë fatkeqësie. Mirëpo a e keni ditur se nga e ka origjinën kjo ëmbëlsirë? Fjala Hallvë apo "helva", rrjedh nga gjuha arabe që do të thotë "i/e ëmbël". Megjithatë kjo nuk do të thotë se edhe origjina e ëmbëlsirës është nga Arabia. Deri në shekullin e 18-të në Perandorinë Osmane të gjitha ëmbëlsirat quheshin helvas. Pra hallvë për herë të parë është përgatitur në Perandorinë Osmane. Ëmbëlsira gatuhet nga të gjitha shtresat e popullsisë Irene Melikoff, në një ndër artikujt e saj mbi "Ceremoninë (Festën) e Hallvës" tregon se "Festa e Hallvës" e humbën natyrën e tyre festive gjatë kohërave deri në shekullin e 17-të, duke u kthyer si shoqërues ushqimor në tavolinat e shtruara për djemtë pasanikë qytetarë gjatë argëtimeve rreth sofrave mondane në periudhën e dimrit. Në ditët e sotme, hallva ka marrë një kuptim tjetër. Ajo gatuhet në kujtim të shpirtrave të vdekur dhe detyrimisht duhet shpërndarë në vëllazëri, fqinj dhe miq.

# Moti i keq sjell kaos në Shkup









*Shkup, 10 maj*- Shiu i përcjellë me breshër e furtunë gjatë ditës së shtunë, në Shkup dhe rrethinë ka shkaktuar shumë dëme material, por fatmirësisht nuk pati viktima në njerëz. Kulme shtëpishë të rrënuara, drunjtë të thyer e të shkulur, vetura të shtypura dhe bulevarde të vërshuara, kjo ishte pamje e tmerrshme me të cilën shkupjanët u ballafaquan gjatë orëve të paradites së 9 majit. Raportet zyrtare të organeve lokale njoftojnë se vetëm në bulevardin "Cvetan Dimov" në Komunën e Çairit janë dëmtuar mbi 10 vetura. Njëkohësisht përgjatë kësaj rruge është konstatuar thyerja e më shumë drunjtë, të cilët për disa ore gjatë vikendit të kaluar e bllokuan qarkullimin e lirë në këtë pjesë të kryeqyteti. Kaos i vërtet pas çdo të përkeqësimi të moti i cili shoqërohet me të reshura të shumta në mase të madhe krijohet brenda lagjes Saravë në Çair. Rrjeti i vjetër i kanalizimit dhe ndërtimet e pakontrolluara të dekadës së fundit paraqesin shkaqet kryesore se pse rrugicat e kësaj lagje të vjetër, dy apo tre herë brenda vitit i ngjajnë "kanaleve të Venecias". Mbetet të shihet se vallë autoritet e Komunës së Çairit do të formojnë ndonjë Këshill i cili do të merret me vlerësimin e dëmeve nga të reshurat, të cilët shpesh herë banorëve të Seravës u shkaktojnë dëme në orenditë shtëpiake dhe aparaturën e amvisërisë. Krahas Shkupit të vjetër i cili vazhdimisht ballafaqohet me probleme , furtuna e vikendit të kaluar ka shkaktuar kaos edhe në pjesën tjera të kryeqytetit. Bulevardi "Aradha Partizane", pjesë të qendrës dhe nën kalimet në Autokomande e rrethinë për disa orë të tëra i ngjanin një qyteti të lëshuar dhe të braktisur. Megjithatë, pasi intensiteti i të reshurave u ngadalësua shërbimet e Qyteti të Shkupit, për shkurt kohë i pastruan pikat kritike.

Ndryshe, raporti zyrtar i Qendrës Meterologjike ka njoftuar se në orët e para ditës së 9 majit, në Shkup dhe rrethinë brenda 25 min janë matur 11 litra në metër katror. Për shkak se këto të reshura i ngjanin furtunës së vërtet, nga kjo qendër theksojnë se shpejtësia e erës ka arritura deri në 80 km/h. Përveç shkuljes së drunjtëve dhe dëmtimit të veturave këto të reshura gjithandej kryeqendrës shkaktuan ndërprerje të vogla të furnizimit me rrymë elektrike. (O.XH.)







# A ka ndasi në qeverinë e Maqedonisë lidhur me emrin?



Gazeta "Kathimerini" shkruan se negociatat midis Greqisë dhe Maqedonisë janë ndërpre, dhe arsyeja është "interpretimi" i dokumenteve ligjore dhe jo në parimet e marrëveshjes. Sipas gazetës, Kryeministri Zoran Zaev dhe Ministri i Jashtëm Nikolla Dimitrov pritet të bien dakord në 24 orët e ardhshme.

"Pas dallimeve të dukshme midis Kryeministrit Zaev dhe Ministrit të Jashtëm Dimitrov si pengesë në proces, pritet që të dy do të dorëzojnë një mesazh të marrëveshjes në 24 orët e ardhshme", thotë Kathimerini. Në një intervistë të botuar në Nea Celida, zëdhënësi i qeverisë greke, Dimitris Senakopoulos, shprehu optimizëm për rezultatet pozitive të negociatave.

Informacionet thotë se Qeveria e Shkupit ka një ndarje me Dimitrovin, i cili vazhdon "të luajë lojë personale ", raportoi gazeta Ta Nea.

Qeveria hedh poshtë pretendimet në disa media për ndarje dhe mosmarrëveshje. Sipas zëdhënësit të qeverisë Mile Bosnjakovski, nuk ka ndarje në qeverinë e Zaevit Ai pohon se Qeveria është përkushtuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe forcimin e dinjitetit dhe identitetit të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

PROPOZIM LIGJI I RI PËR FATURAT E PAPAGUARA

# A DO TË SHLYHEN KAMATAT NGA BORXHET E VJETRA?

Mbi 200 mijë qytetarë që vazhdojnë të kenë të bllokuara llogaritë bankare nga ana e përmbaruesve për shkak të mos pagesë së borxheve të mbetura të faturave energjetike, ujit, bërllokut, faturave ndaj operatorëve të telefonisë fikse dhe celulare si dhe operatorëve kabllovikë, me miratimin e propozim ligjit të ri për shlyerjen borxheve dorëzuar nga partia opozitare VMRO do të lirohen nga pagesa e kamatave të borxheve të vjetra më shumë se 10 vite dhe do të mund të paguajnë vetëm borxhin bazë

Koha Zejnulla VESELI



*Shkup, 10 qershor* – Të gjitha borxhet e vjetra, që janë në proces të përmbarimit, të energjisë elektrike, ujit, bërllokut dhe shërbimeve tjera të operatorëve telefonik dhe kabllovikë, përfundimisht me vitin 201, qytetarët e Maqedonisë do të mund t'i shlyejnë pa mos paguar kamatë apo harxhimet plotësuese.

Kështu parasheh Propozim Ligji për shlyerjen e borxheve të vjetra përgatitur nga partia opozitare VMRO-DPMNE i cili pritet së shpejti t'i dorëzohet Parlamentit të Maqedonisë për shqyrtim dhe miratim. Sipas opozitës propozim ligji në fjalë ka të vetmin qëllim të shlyejë të gjitha borxhet e vjetra të mbetura nga qytetarët e Maqedonisë deri në fund të muajit dhjetor të vitit 2011. Nga partia opozitare thonë se nëse ky ligj pranohet edhe nga deputetët e shumicës parlamentare, një numër i konsiderueshëm të qytetarëve që kanë borxhe të vjetra deri në fund të vitit 2011 do të përfitojnë sepse do t'iu shlyen të gjitha kamatat llogaritura nga ana debitorëve.

" Kushti i vetëm për t'u fshirë borxhi është pagesa e borxhit bazë, pa kamatat dhe harxhimet e përmbarimit, që shpesh herë kamatat dhe taksat e llogaritura nga përmbaruesit për procedimit e lëndës e kanë tejkaluar shifrën bazë të borxhit për dhjetë herë më shumë. Bëhet fjalë për periudhën e borxheve të lëshuara nga kreditorët deri te qytetarët nga dita e parë e deri në ditën e pagesës, që do të thotë se qytetari do të lirohet tërësisht nga pagesa e normës së interesit të llogaritura deri në fund të vitit 2011. Lidhur me shpenzimet e përmbarimit propozohet zvogëlim prej 50%, që gjithashtu është shumë e konsiderueshme dhe këto dy faktorë deri më tani ishin arsyeja për mijëra qytetarë me borxhe pa fajin e tyre t'u nënshtrohen shpenzimeve të larta në bazë të normës së interesit", thonë nga partia opozitare VMRO-DPMNE.

Në pajtim me zgjidhjet ligjore për borxhet e vjetra më shumë se një dekadë për të cilat qytetarët nuk kanë pasur njohuri janë të detyruar të paguajnë për dhjetë herë më shuma më të larta se borxhi bazë. "Deri më sot nuk ka ekzistuar ndonjë mënyrë se si të mbrohen qytetarët nga keqpërdorimet që u bëjnë kreditorët si dhe përmbaruesit. Kreditorët dhe përmbaruesit në mënyrë të shkëlqyer e kane shfrytëzuar këtë periudhë dhjetëvjeçare në dëm të qytetarëve duke u kërkuar atyre të paguajnë borxhet e vjetra bazë, të cilat pas llogaritjes së kamatave nga ana e kreditorëve dhe përmbaruesve nga 1000 denarë të shkojë e të bëhet 30 mijë denarë", thonë nga partia opozitare maqedonase. Këtë propozim ligj me sa duket do ta mbështesin edhe deputetët e LSDM-së.

"Për të gjitha institucionet kreditore të cilat janë të themeluara nga Qyteti i Shkupit, nga komunat, propozim ligji qartë parasheh se do të shlyhet norma e interesit. Do të thotë se kemi dy lloj borxhlinj. Disa që atë do ta bëjnë në bazë vullnetare, ndërsa ata janë kreditorët privatë, siç është EVN dhe kreditorë para së gjithash për shërbime komunale", thonë nga LSDM.

Të dhënat e fundit të Bankës Popullore të Maqedonisë tregojnë se mbi 200 mijë qytetarë vazhdojnë të kenë të bllokuara llogaritë bankare nga ana e përmbaruesve për shkak të mos pagesë së borxheve të mbetura të faturave energjetike, ujit, bërllokut, faturave ndaj operatorëve të telefonisë fikse dhe celulare si dhe operatorëve kabllovikë.

# MPB: Nuk do të ketë ndryshime kadrovike në njësitin "Tigrat"

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) informon opinionin se përkatësia partiake, fetare, apo ndonjë tjetër, nuk është dhe nuk do të jetë kriter për ngritje profesionale në detyrë në strukturat organizative të ministrisë. MPB-ja kategorikisht demanton njoftimet në media, për gjoja ndryshime kadrovike në njësinë speciale "Tigrat", respektivisht ndryshime komanduese. Sipas kësaj ministrie, bëhet fjalë për një lajm krejtësisht tendencioz dhe të pavërtetë. Përndryshe, portale online të afërta me opozitën maqedonase publikuan lajme për emërimin e një shqiptari në pozitë të lartë në këtë njësi speciale.



# Do të kërkohet përgjegjësi penale për skenaristët e "Sopotit" dhe "Monstrës"






Përveç kërkesës së dorëzuar për dëmshpërbilimin material për të liruarit e rastit të Sopotit, avokati mbrojtës Naser Raufi thekson se do të kërkojnë edhe përgjegjsi penale për të gjithë ata që e inskenuan këtë rast. Si persona të involvuar ai numëroi dëshmitarët e rastit gjegjësishit inspektorët që kishin marrë në pyetje dëshminë e ëshmitarit të mbrojtur si kryesore mbi këtë rast. Përgjegjësi penale ai gjithashtu paralajmëroi edhe për siç tha personat apo subjektet që e montuan rastin Monstra,por kjo pas epilogut përfundimtarë gjyqësorë, ngaqë thekson se është i bindur në pafajsinë dhe lirimin e tyre.

"Sigurisht se ni si palë mbrojtëse përveç dëmshpërblimit që është në procedurë do të kërkojmë edhe përgjegjësinë e atyre që e montuan këtë rast. Me kolegun Paçuku jemi duke e përcjellur këtë lëndë dhe provat që I kemi siguruar do të përgaditemi që të ngrejmë padi penale kundër personave të involvuar. Këtu praktikisht janë përsonat që ishin edhe dëshmitarë. Mendoj që patjetër duhet të ketë përgjegjësi për këtë lëndë si masë preventive edhe për rastet e tjera të montuara siç është Monstra. Edhe për lëndën e Monstrës do të kërkojmë përgjegjësinë e personave, subjekteve që e montuan këtë lëndë por pas epilogut final të lëndës. Mendoj se do të ket tërheqje edhe në këtë lëndë, epilog që ti lirojë gjykata", tha Naser Raufi, avokat mbrojtës. Sa i përket rastit të Kumanovës per te cilin ekyistojne dënime të larta dhe burgje të përjetshme për shtetas të vendit dhe jashte, Raufi thote qe presin ekipin e prokuroreve nderkobetar te involvohen ne kete rast. "Për rastin e Kumanovës presim që të reagojnë ndërkombëtarët në mënyrë që do ta formojnë timin prej prokurorëve të krimi të organizuar dhe presim që në një periudhë të shkurtë para seancës së gjykatës së apelit që të kemi ndonjë paralajmëim për këtë involvim të ndërkombëtarëve në këtë rast", tha Raufi.Si pakënaqësi ndaj këtyre rasteve veçmas dhe në tërësi disa herë u zhvilluan protesta në kryeqytet. Ata kërkonin që të gjitha rastet e montuara me motive të rividohen dhe të rikualifikohen, si dhe kerkuan bartje edhe te pergjegjesise nga aktoret e vëtetë.

PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE

# DO TË MBIKËQYRIN DY MIJË ARSIMTARË

**Nga Qendra Shtetërore e Provimeve bëjnë të ditur se mbi 2000 arsimtarë, anëtarë të komisioneve shkollore e ndjekin ecurinë e provimeve. Krahas tyre janë edhe 180 mbikëqyrës të autorizuar, të cilët shpërndahen nëpër shkolla ditëve të provimit. Të shtunën, provimet e gjuhëve amtare janë realizuar pa probleme, ndërsa të hënën dhe të mërkurën do të mbahen provimet e mbetura nga lista e lëndëve zgjedhore**



Koha Laura PAPRANIKU

*Shkup, 10 qershor* - Rreth 15 mijë maturantë iu nënshtruar të shtunën provimeve të gjuhës amtare, respektivisht lëndëve nga gjuha dhe letërsia maqedonase, gjuha dhe letërsia shqipe dhe gjuha dhe letërsia turke varësisht asaj se në cilën gjuhë e kanë zhvilluar mësimin. Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) thonë se provimet kanë nis në kohë dhe se nuk janë shënuar probleme që eventualisht do të dëmtonin procesin. Sikurse dihet, në Maqedoni dhënia e provimeve të Maturës Shtetërore është kusht për vijim e shkollimit të mëtutjeshëm dhe për këtë arsye, thuajse të gjithë ata që mbarojnë shkollën e mesme i nënshtrohen këtij procesi. Notimi për tre provimet e Maturës Shtetërore bëhet nga një komision i jashtëm, për çka njihen ndryshe edhe si provime eksterne të Maturës, ndërsa në rast pakënaqësie nxënësit kanë të drejtën e parashtrimit të ankesave të cilat duhet të shqyrtohen në afat prej 15 ditë nga dita e dorëzimit të tyre në Qendrën Shtetërore të Provimeve (QSHP)

Provimet nga lënda e maqedonishtes, shqipes dhe turqishtes (pra gjuhëve në të cilat zhvillohet mësimi) janë të detyrueshme dhe pa mundësi zgjedhje, si në rastin e provime tjera. Për afatin e qershorit, sipas numrit të provimeve të paraqitura, verifikimit të dijeve në lëndën e maqedonishtes iu nënshtruan 10.119 nxënës, në lëndën e shqipes 4.474 dhe në gjuhën turke 373 nxënës. Edhe pse jo të gjithë maturantët i akne paraqitur provimet në afatin e qershorit dhe jo të gjithë zgjedhin maturën shtetërore, prapë se prapë numrat në fjalë konfirmojnë përqindjet e përgjithshme të pjesëmarrjes së nxënësve në shkollat e mesme sipas gjuhës në të cilën e zhvillojnë mësimin. Në informacion që ka përgatitur QSHP për provimet që u mbajtën të shtunën thuhet se 67.5 për qind e provimeve ishin në lëndën e gjuhës maqedonase, 30 për qind në gjuhën shqipe dhe 2.5 për qind në gjuhën turke. "Më 9 qershor u realizua pjesa me detyrim e provimeve të Maturës shtetërore në të gjitha shkollat publike dhe në një pjesë të shkollave private për nxënësit e gjimnazeve, shkollave të artit dhe arsimit të mesëm profesional me kohëzgjatje katërvjeçare. Për këtë provim ishin paraqitur 14.966 kandidatë. Prej tyre 67.5 për qind iu nënshtruan provimeve në lëndën e gjuhës dhe letërsisë maqedonase, 30 për qind në lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe 2.5 për qind në lëndën e gjuhës dhe letërsisë turke". Provimet, thuhet më tej, në të gjithë vendin u mbajtën në përputhje me të gjitha rregullat dhe procedurat përkatëse, pa asnjë problem. Për të ndjekur ecurinë e procesin ishin përfshirë anëtarët e komisioneve shkollore të maturës si dhe rreth 2000 testues-arsimtarë, të trajnuar për këtë qëllim si dhe 180 mbikëqyrës të autorizuar nga QSHP-ja, BZHA-ja dhe QAPT-ja. Të gjitha provimet nisin në ora 10.

Nesër do të realizohen provimet nga lista e lëndëve zgjedhore, apo provimet e treta për të cilat nxënësit janë përcaktuar paraprakisht: biologji, kimi, fizikë, histori, biznes, filozofi dhe estetikë. Në nivel shteti në këto provime interesimi më i vogël është treguar për fizikën, të cilën e kanë paraqitur vetëm 100 nxënës edhe atë 94 maqedonas dhe 6 shqiptarë, kurse më shumë për lëndën e biznesit (3993) dhe biologjisë (3737). Të mërkurën, më 13 qershor, do të mbahen provimet nga lënda e matematikës e që janë njëra pjesë e provimeve të dyta të Maturës shtetërore. Nxënësit kishin mundësi të zgjedhin provim mes matematikës dhe lëndëve të gjuhëve të huaja të cilat u organizuan të shtunën e javës së shkuar. Për provimin e matematikës do të jenë 1.926 nxënës, prej të cilëve 1.728 maqedonas, 164 shqiptarë dhe 34 turq. Të krahasuara me numrin sipas gjuhëve në të cilat zhvillojnë mësimin, i bie që në masë më të madhe ta shmangin këtë provim shqiptarët, pasi i bie që vetëm 3.7 për qind e atyre që kanë provim gjuhën shqipe ta kenë provim edhe matematikën. Të maqedonasit kjo përqindje është më e lartë (17 për qind), kurse te turqit 9 për qind. Në nivel të gjitha shkollave të mesme, numri i atyre që paraqesin matematikën si provim mature nuk është as 13 për qind.

## Gashi: BESA të jetë opsioni i parë i shqiptarëve



"Besa do të jetë opsioni i parë i shqiptarëve, nëse tregojmë rezultate të mira me hyrjen tonë në Qeveri", shprehet Afrim Gashi, kryetar i Lëvizjes Besa. Në intervistën javore për Radio Evropa e Lirë, ai thotë se ndjehen tej mase të zhgënjyer me ndarjen e Besës, sepse nuk e kanë pritur një "attack të kombinuar" edhe nga brenda edhe nga jashtë, por shprehet se njerëzit më të mirë të këtij subjekti vazhdojnë të mbështesin Besën dhe në këtë mënyrë do të tregojnë rezultate të mira. I pyetur se si do të jetë bashkëpunimi me BDI-në tani në Qeveri, Gashi ka thënë se do të jetë i rëndë dhe se beson se ata do të bëjnë gjithçka që t'i bëjnë opstrukcione BESËS. "Megjithatë ky është një paragjykim i imi, do të doja të mos jetë e vërtetë, do të doja çdokush ta bëj punën e vet. Dëshirojmë të implementojmë atë që e kemi biseduar, nuk dëshirojmë të përplasemi me asnjë. Qasja jonë ndaj BDI-së dhe LSDM-së është në drejtim se na përfundon mundësia për t'i kritikuar, por e kemi të hapur mundësinë të tregojmë se jemi shumë më të mirë se ata", ka thënë Gashi.

## Të akuzuar nga Maqedonia ankohen në Gjykatën e Strazburgut

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Starburg, për "Makfax" ka vërtetuar informatat, se deri tek ata, gjatë këtij viti kanë arritur disa ankesa nga avokatë të të akuzuarve në rastet e Prokurorisë Speciale Publike në Maqedoni, transmeton Portalb.mk. Megjithatë, nuk dihet ende se nëse për ndonjërën ankesë është sjellë vendim, se është bërë shkelje e të drejtave të të ndonjërit prej të akuzuarve.

Sipas informatave jozyrtare, njëra nga ankesat që të akuzuarit e PSP-së e kanë dërguar në Strasburg, ka të bëjë me lejimin e përdorimit të "bombave" si dëshmi gjyqësore.

Se janë dërguar ankesa në Strasburg, këtë e ka bërë të ditur edhe Donçe Nakov – avokat mbrojtës i ishkryeministrit të Maqedonisë dhe ishliderit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski i dënuar në rastin "Tank", për blerjen e "Mercedesit" luksoz

## Lazim Destani takon në Dyzeldorf, fituesin e Çmimit Nobël për Paqë



Lazim Destani sot në Klubin Ekonomik në Dyzeldorf ka zhvilluar një takim me Nobelistin, Kailash Satyarthi. Ishte ky një takim miqësor ku Destani është njohur me punën frymëzuese ndër vite të z. Satyarthi, përfshirë çlirimin e mijëra fëmijëve indianë nga angazhimi në punë, skllavëria dhe trafikimi i tyre. Satyarthi ka punuar nëpër shumë organizata që angazhohen kundër përfshirjes së fëmijëve në punë si dhe për të drejtat e fëmijëve për shkollim. Ai e fitoi Çmimin Nobël për Paqe në vitin 2014. Destani gjithashtu gjatë bisedës me mikun e tij paraqiti detaje mbi vështirësitë ekonomike, shoqërore dhe edukative që rëndojnë mbi fëmijët dhe të rinjtë në rajonin e Europës Juglindore.

DREJT NJË QASJE TJETËR NË KUJDESIN SHËNDETËSOR

# TRAJTIMI NJËDITOR, NEVOJË E KOHËS

Ka raste kur pacientët do të duhet të monitorohen brenda një kohe të shkurtër e jo të hospitalizohen më gjatë. Vendimi i Qeverisë për inicimin e spitaleve ditore, si ide është pozitive, por deri në realizim duhet punë



Koha Delvina KËRLUKU

*Shkup, 10 qershor* - Klinikat e Maqedonisë do të hapin reparte të veçanta ku do të trajtohen rastet mjekësore, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të shpejtë kirurgjikale. Ky do të jetë një lehtësim i madh për pacientët, të cilët nuk do të kenë nevojë për hospitalizim më të gjatë, pra do të trajtohen në bazë ditore. Mjekët thonë se ndërhyrjet mjekësore brenda ditës mund të bëhen vetëm për sëmundjet më pak të ndërlikuara dhe jo për ato më të vështira. Por, gjithsesi se mjekimet e tilla kërkojnë kushte, staf mjekësore profesional. Mjekët, po ashtu sqarojnë se bëhet fjalë për procedurat kirurgjikale që do të trajtohen dhe që janë të thjeshtëzuara. Pas kontrollit të nevojshëm preoperator, i cili kryhet gjatë ditës, pacienti i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale dhe më pas kalon në dhomën e pushimit ku qëndron për një kohë të shkurtër e largohet për në shtëpi brenda po të njëjtës ditë që është kryer ndërhyrja kirurgjikale.

Një ndryshim i këtillë në klinika është mjaft efikase, thotë Gëzim Nuredini, për arsye se ka raste kur pacientët do të duhet të monitorohen brenda një kohe të shkurtër e jo të hospitalizohen më gjatë, ku edhe bëhet një analizë më konkrete, ndonjë terapi eventuale dhe brenda ditës pacienti do të ik në shërim shtëpiak, nëse i plotëson kushtet shëndetësore. Këtu bëhet fjalë për monitoring dhe ndonjë diagnostikë, intervenime të lëkurës, sëmundjet infektive edhe për intervenime që mund të bëhen për një ditë. Ai mendon se vendimi i Qeverisë për inicimin e spitaleve ditore, si ide është pozitive, por deri në realizim duhet punë, ku edhe do të shihen se cilat janë mangësitë dhe ku duhet të merren masa konkrete.

"Ka probleme, si në reforma, në mungesë personeli, për shkak të mjekëve që kanë ikur dhe për arsye se teknologjia e re kërkon sofistikime të reja në mjekësi, ku sigurisht trendet duhet të ndiqen, prandaj duhet reforma edhe në pjesën e pajisjeve medicinale, gjë që do të thotë se punët në Maqedoni janë ende të kufizuara" thotë mjeku i përgjithshëm Gëzim Nuredini, për gazetën "Koha".

Studenti i Mjekësisë në Shkup, Arbijon K. thotë se Ideja e "one day surgery" (trajtim një ditor) ose "out patient", gjegjësisht procedura pa qëndrim nate në spital në rastet kur nuk ka nevojë për mbikëqyre mjekësore të pacientit, që praktikohet në vendet perëndimore veçanërisht në Britaninë e Madhe, si koncept ka një efikasitet të madh praktik dhe ekonomik, në një vend me organizim të përkryer të sferës së shëndetësisë, por është e vështirë të praktikohet diçka e tillë në vendin tone. Pikë së pari si pasojë e mungesës se kuadrove por dhe e bashkëpunmit jo të mjaftueshëm të nivelit primar dhe atij tercier në shkallë rajonale. Arbijoni mendon se problemi kryesor që do ta pengojë inkuadrimin e këtij projekti është jotriazhimi kualitativ i pacientëve nga mjekët amë dhe udhëzimi i tyre në njësi terciere. Por nuk përjashton faktin që ngelet për të përshëndetur vullnetin e mirë për të ngjasuar me shtetet e zhvilluara perëndimore. Ai sugjeron se fokusimi duhet të jetë në nivelin primar, edukimi kualitativ i vazhdueshëm dhe revidimi i shpeshtë i licencave profesionale të tyre. Dhe nëse i rregullojmë këto fenomene koncepti 'trajtimi një ditor' do vjen si pasojë e suksesit të mjekëve.

Deri më tani operacionet mikrokirurgjikale janë bërë në Shkup, veçmas në spitalet gjinekologjike, ku pacientet ka qëndruar më pak se 8 orë, pas abortit. Po ashtu, në sallën e kirurgjisë plastike. Kjo iniciativë e Qeverisë mendohet të ulë shpenzimet e Fondit për sigurim shëndetësor. Ndërsa, nga qeveria thonë se në këtë drejtim do të përgatiten udhëzime dhe do të përshtaten hapësira me kushte të posaçme në suaza të spitaleve të përgjithshme dhe klinikave ku ekzistojnë mundësi bazuar në vlerësimin e kryer.

Publicitet

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015) dhe nenit 71 të Statutit të SHFK "Petar Pop Arsov" – Bogomilla, ndërsa në lidhje me vendimin e Komunës Çashka me nr. 04-1308/2 të datës 22.11.2017, Këshilli i shkollës publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT**

**Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e nevojshme në vijim:**
- të ketë të mbaruar arsimin sipëror;
- të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në institucion edukativo-arsimor të verifikuar nga MASH;
- të përmbushë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në arsim fillor;
- të ketë të dhënë provimin për drejtor;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
-të mos jetë i dënuar për vepër penale, që e bën atë të papërshtatshëm për kryerje të punës edukativo-arsimore.
- të jetë i shëndoshë psikofizikisht dhe i aftë për punë

**Kandidatët të cilët do të paraqiten në konkurs duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:**
- CV me Letër motivimi;
- dëshmi për arsim të mbaruar;
- vërtetim për përvojën e punës në institucion edukativo-arsimor
- vërtetim se nuk është i dënuar për vepra penale që e bën atë të papërshtatshëm për kryerje të punës edukativo-arsimore;
- vërtetim mjekësor me çka dëshmohet se është i shëndoshë psikofizikisht
- dëshmi për provim të dhënë për drejtor;
- certifikatë të shtetësisë;
- program për punë për periudhë prej 4 vjet.
- vërtetime të tjera dhe dokumente për kualifikime të fituara

**Shpallja publike zgjatë tetë (8) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të të njëjtit.**
Lutja me shtojcat parashtrohen deri te Këshilli i shkollës së SHFK "Petar Pop Arsov" – Bogomilla
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

KËSHILLI I SHKOLLËS SË SHFK "Petar Pop Arsov" – Bogomillë

Në bazë të nenit 89-a, 91 dhe 92-a të Ligjit për arsim të mesëm, ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 44/95; 24/96; 34/96; 35/97; 82/99; 29/02; 40/03; 42/03; 67/04; 55/05; 113/05; 35/06; 49/07; 92/08; 33/10; 116/10; 156/10; 18/11; 42/11; 51/11; 6/12; 100/1; 24/13; 1/14; 116/14; 135/14; 10/15; 98/15; 145/15; 30/16; 127/16; 67/17 dhe 64/18), dhe nenit 129 paragrafi 1 alineja 7 e Statutit të SHMK "Jane Sandanski" nga Shtipi, Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur më datë 15.05.2018 ka sjellë Vendim për publikim të

**SHPALLJE PUBLIKE**
**Për zgjedhje të drejtorit të SHFK "Jane Sandanski" – Shtip**

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet në vijim:
- të përmbushin kushtet për mësimdhënës, pedagog ose psikolog në shkollë të mesme;
- të ketë të mbaruar arsim sipëror;
- të ketë pesë vjet përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- të ketë të dhënë provimin për drejtor;
- të ketë shëndet psikofizik dhe i aftë për punë.

Kandidatët për drejtor të shkollës duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me CV (biografi të shkurtë) dhe letër motivimi,
- Diplomë për arsim sipëror të mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- Vërtetim për përvojën e punës në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë të shtetësisë së RM jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj,
- Certifikatë të mjekut,
- Vërtetim se nuk është sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Certifikatë se nuk është i dënuar,
- Program për zhvillim të shkollës për periudhë prej katër vjet,
- Vërtetime të tjera dhe dokumente për kualifikime të fituara,

Neto pagesa bazë është 38.513.00 denarë dhe orari i punës është prej ora 7.00 deri në ora 15.00, gjegjësisht 40 orë të punës në javë.
Shpallja zgjatë tetë (8) ditë duke filluar të rrjedhë nga dita e ardhshme e ditës së publikimit në shtypin ditor.
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.
Intervista me kandidatët e paraqitur të cilët i përmbushin kushtet për drejtor, do të realizohet nga ana e anëtarëve të Këshillit drejtues dhe përfaqësuesit të Byrosë për zhvillim të arsimit, për çka kandidatët do të informohen enkas.
Zgjedhja e kandidatit do të realizohet në afatin në pajtim me nenin 92-a të Ligjit për arsim të mesëm.
Dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri te Këshilli i shkollës së SHMK "Jane Sandanski" Shtip deri te arkivi i shkollës ose përmes postës në adresën SHMK "Jane Sandanski" Shtip, rr. "Trajko Koshevski" nr. 2A, 2000 Shtip, R. Maqedonisë, tel. për kontakt 032-391-006.

15.05.18
Shtip

Kryetari i KD të SHMK "Jane Sandanski" Shtip

/Novit Zdravev /

## FONDE EVROPIANË PËR BUJQËSINË

# IPA MË AFËR FERMERËVE



Bashkimi Evropian sivjet do të mbështesë zhvillimin e bujqësisë me 15 milion euro. Me mjetet fondet evropiane IPA 2019 do financohen më shumë projekte bujqësore në shtet si ndërtimi i më shumë sistemeve të vogla për vaditje me harxhime të vogla që nuk dëmtojnë ambientin , ndërsa ndihmojmë fermerët në viset rurale që të sigurojnë ekzistencën e tyre

Koha Fisnik PASHOLLI

*Shkup, 10 qershor* – Bashkimi Evropian sivjet do të mbështesë zhvillimin e bujqësisë Maqedoni, me 15 milion euro. Me mjetet fondet evropiane IPA 2019 do financohen më shumë projekte bujqësore në shtet si bashkimi i tokave bujqësore, projekte nga shëndeti i kafshëve, kontrolli fitosanitar , si dhe ndërtimi i më shumë sistemeve të vogla për vaditje me harxhime të vogla që nuk dëmtojnë ambientin , ndërsa ndihmojmë fermerët në viset rurale që të sigurojnë ekzistencën e tyre. Nga delegacioni i Bashkimit Evropian në Shkup që javën e kaluar së bashku me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, institucionet e tjera kompetente në sektorin e bujqësisë, donatorët e huaj dhe organizatat e tjera joqeveritare përcaktuan projektet me prioritet të realizimit , thonë se angazhohen për financimin e projekteve në rajonet më pak të zhvilluara si rajoni Jugperëndimor ku bën pjesë Ohri, Struga, Dibra apo Kërçova , Verilindor ku bëjnë pjesë Kumanova, Likova , Kriva Pallanka etj dhe rajoni i Pollogut .

Në ndërkohë , në ndërtimin e sistemeve për vaditje do të përfshihet ndër të tjerash edhe një lokalitet në Kërçovë. Afër 160 hektarë të tokës bujqësore do të përfshihen me sistemin e ri për vaditje "Kolibari", në Kërçovë që do të shfrytëzohet nga ana e 100 bujqve të këtij rajoni. Dokumenta Cioni projektues do të jetë gati deri në muajin shtator të këtij viti, ndërsa për ndërtimin e sistemit do të harxhohen 1.4 milion euro. Projekti u promovua në fund të muajit maj para prodhuesve të fshatrave Kolibar, Crvevci, Mamudovci dhe Lazarovci .

"Për realizimin e këtij projekti nevojitet që deklarata të nënshkruajnë afër gjysma e bujqve të kësaj zone. Njëherazi Bashkimi Evropian ka ndihmuar Ministrinë e Bujqësisë për përgatitjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e tetë sistemeve të vogla për vaditje që do të ndërtohen në mënyrë të barabartë në tërë Maqedoninë" theksoi në prezantimin e projektit , ,sekretari shtetëror në Ministrinë e Bujqësisë , Nefruz Çeliku. Sipas tij, shfrytëzuesit e fundit të këtyre sistemeve të vaditjes , do të jenë bujqit e vegjël që nuk përfshihen me sistemet e mëdha të vaditjes .Qëllimi i këtij projekti është të kontribuojë për rritjen e konkurrencës së bujqësisë . Nga mekanizmi IPA , për tetë sistemet e vogla për vaditje janë siguruar gjashtë milion euro, ndërsa 4.6 milion euro janë siguruar nga arka e shtetit thotë më tej Çeliku.

Në ndërkohë, për herë të parë , ndihmë financiare nga IPA 2019 do të fitojë sektori i pylltarisë në drejtim të vendosjes së sistemit informativ të pyjeve , si komponentë e rëndësishme për ekonomizim të qëndrueshëm të pyjeve , dhe krijim të politikave për afrim të pylltarisë së Maqedonisë ndaj rrjedhave moderne dhe sigurim të të dhënave që janë të rëndësishme për zhvillimin e këtij sektori. Për konsolidimin apo bashkimin e tokave bujqësore nga parcela më të vogla në parcela më të mëdha bujqësore do të harxhohen afër 500 mijë euro para evropiane, ndërsa do të mbështetet edhe krijimi i kooperativave bujqësore, si një nga modelet për avancimin e bujqësisë vendore. Me mjetet e IPA 2019 do të mbështeten edhe veprimtaritë këshillëdhënëse , në drejtim të krijimit të një sistemi evropian këshillëdhënës për bujqit. Njëherësh do të mbështet financiarisht edhe vendosja e sistemit për nusprodhimet apo mbeturinat me prejardhje nga kafshët, që ka një rëndësi të veçantë në aspektin e kontrollit të sëmundjes së kafshëve. Me afër 1.5 milion euro do të financohen politikat fitosanitare për lidhjen më të mirë të sistemit fitosanitar me sistemet e tjera në sektorin e bujqësisë, ndërsa do të mbështetet edhe GEN-banka për ruajtjen e sortave dhe farave autoktone të Republikës së Maqedonisë.

# Varfshmëria e Maqedonsië nga gazi natyror

Të nevojshme janë vetëm 250 milionë metra kub gaz, por Maqedonia është më e varur nga të tjerët në rajon, shumica e të cilave kanë një rrjet aktiv ose do të ndërtojnë terminalet. Ndërsa shumica e luftës për sa më shumë alternativa të furnizimit zhvillohet, Maqedonia është ende duke pritur për një tjetër opsion



*Shkup, 10 qershor* - Deri tani vetëm gazin rus mund të dorëzohet përmes Korridorit Ndërkombëtar 8, i cili kalon përmes Ukrainës, Moldavisë, Rumanisë dhe Bullgarisë. Ambasadori i SHBA Jesse Baisley në konferencën "Forumi Maqedonas i Energjisë 2018" në Strugë tha se Maqedonia është një nga vendet më të varura se të tjerët në rajon dhe në botë se si dhe nëse gazi do të vijë, dhe kjo është konfirmuar nga argumentet e raportit Bulgartransgaz për 10 vitet e ardhshme, të paraqitura përmes "Kapitalit" bullgarë, shkruan Flaka.

"Shtetet e Bashkuara kanë kohë që po mbështesin projekte të tilla si korridori i gazit jugor, i cili do të lejojë që Evropa qendrore dhe jugore të fitojë akses në gazin nga Azerbajxhani. Gjithashtu, eksporti i gazit natyral të lëngshëm nga Shtetet e Bashkuara fillon të eksportojë në terminalet verior dhe Greqin", shtoi ambasadori i SHBA.

Bullgaria po përpiqet të bëhet një lojtar rajonal në shpërndarjen e gazit natyror dhe optimizmi i kryeministrit Bojko Borisov pas takimit me presidentin rus Vladimir Putin po rritet. Bullgaria duhet të filloje ndërtimin e lidhjes me "Rrjedhën Turke", dhe rrjeti do të jetë gati deri në vitin 2020. Por për këtë, siç pretendon Kapital, nevojiten klientë të qëndrueshëm dhe i vetmi blerës i besueshëm për blerjen përmes Bullgarisë është vetëm Maqedonia.

Çështja është nëse do të jetë e mjaftueshme për shkak të nevojës për likuiditet, nevojiten më shumë fonde dhe nevojat e Maqedonisë për momentin janë vetëm 250 milionë metra kub në vit, me parashikimet më optimiste për t'i kthyer ato në një miliard, por vetëm nëse ekonomia po përparon me shpejtësi dhe po ndërtohet infrastruktura e mirë.

Koncepti i një qendre të shpërndarjes së gazit në territorin e Bullgarisë është një projekt që punon së bashku me Komisionin Evropian. Vendi po përpiqet të mbajë pozicionin strategjik në hartën e gazit evropian dhe të mos lejojë që ajo të anashkalohet nga projektet kryesore të infrastrukturës.

Nga plani i Bulgartransgaz për zhvillimin e rrjetit në 10 vitet e ardhshme, mund të vëzhgohen disa fakte interesante rreth asaj se si vendet e Evropës Juglindore punojnë për interesat e tyre dhe cilat projekte në sektorin e gazit janë realizuar apo planifikuar, ndërsa në Bullgari ekzistojnë vetëm pjesëmarrje periferike.

Turqia përmes një prej tubave të "Rrjedhës Turke" do të marrë 13 miliardë metra kub të gazit direkt nga Rusia dhe do të bëhet e pavarur nga kompania bullgare, e cila deri tani ka "ndërmjetësuar". Turqia gjithashtu furnizon LNG të lëngshme nga Algjeria dhe Nigeria, importon gaz nga Irani dhe Azerbajxhani dhe zhvillon një program për sigurimin e burimeve të veta. Në fund të majit ajo filloi të zbatojë gjashtë miliardë metra kub të rënë dakord nga fusha e Azerbajxhanit "Shah Deniz 2". Sipas raportit të Bulgartransgaz, Turqia ka kapacitetin për të ofruar dhe transportuar në vendet fqinje në Evropë.

Greqia ka dyfishuar konsumin në katër kub në dhjetë vitet e fundit dhe në të ardhmen do të duhet 5.5. Furnizohet nga terminalet e LNG nëpërmjet Bullgarisë nga Rusia, nëpërmjet një lidhjeje me gazin me Turqinë. Grekët gjithashtu do të marrin gaz nga vendi Shah Deniz 2 dhe gjithashtu do të jenë të lidhur me flotën e cisternës së Mesdheut si një projekt i "interesit të përbashkët" nga Komisioni Evropian. Në Aleksandropulos do të ndërtohet terminali për LNG nga Algjeria, Katari dhe Shtetet e Bashkuara, dhe si klient i mundshëm këtu në kombinim është Maqedonia.

Tubacioni Trans-Adriatik TAP duhet të lidhë Turqinë dhe Italinë nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë dhe duhet të lidhet me gazsjellësin Trans Anatolian që duhet të mbajë gaz nga Azerbajxhani.

Kroacia në ishullin Krk po ndërton një terminal LNG me mbështetje nga BE dhe Shtetet e Bashkuara dhe do të jetë gati në vitin 2020. Nuk është një vend tranzit përmes të cilit mund të kalojë gazi, por me këtë terminal do të sigurojnë dy miliardë kube për vete.

Përveç kësaj, Kroacia, Shqipëria dhe Mali i Zi këtë pranverë lidhën marrëveshje me firmën SOCAR të gazit kombëtar Azerbajxhan për të ndërtuar një tubacion gazi nga Greqia përgjatë bregut të Adriatikut deri në Slloveni, Austri dhe Itali. Qëllimi është të transportojë gazin Kaspik që hynë në Turqi nëpërmjet TANAP.

Serbia furnizon 80 për qind të nevojave të saj me gazin rus nëpërmjet Ukrainës, Rumanisë dhe Hungarisë. Nëse në të ardhmen Rusia vendos të shkurtojë gazin në Ukrainë, ai vend ka burimet e tij të mëdha dhe mund të negociohet me Serbinë, e cila ka një alternativë plus dhe përmes Bullgarisë. Rumania është tërësisht e pavarur dhe konsumon 11 miliardë metra kub me 85 për qind të kapaciteteve të veta.

## Ftesë për shprehje të interesit
**Nr. 012-18/1.1.13**

**Republika e Maqedonisë**
**Projekti për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve**
**Huaja nr.:** 8332-MK

**Pozita**: Konsulent për dizajn dhe vendosje të sistemeve të informacionit për institucionet e akredituara për arsim sipëror

Republika e Maqedonisë ka fituar mjete financiare nga Banka botërore në drejtim të implementimit të Projektit për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve dhe planifikon të shfrytëzojë një pjesë të mjeteve për shërbime konsulente/konsulent individual për dizajn dhe vendosje të sistemit të informacionit për institucionet e akredituara për arsim sipëror në Republikën e Maqedonisë.

Shërbimet konsulente ("shërbmet") përfshijnë vlerësim të biznes proceseve, punën e përditshme dhe nevojat softuerike të institucioneve të akredituara për arsim sipëror, pasqyrë dhe harmonizim me dokumentimin për dizajn dhe zhvillim të bazës qendrore të të dhënave, si dhe pasqyrë të legjislacionit nacional për arsim sipëror. Kohëzgjatja e paraparë e shërbimeve është qershor 2018 – maj 2019. Përshkrimi i detyrave të punës në gjuhën angleze është i mundshëm në http://mon.gov.mk/index.php/dokumenti/2014-07-30-12-00-34/sdis-proekt

Ministria e Arsimit dhe Shkencës fton konsulentët përkatës individual ("konsulentë") të shprehin interesin e tyre për sigurimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të parashtrojnë letër për shprehje të interesit, biografi (CV) dhe informacione/dokumente të tjera me të cilat do të vërtetohet se përmbushë kualifikimet dhe përvojën e nevojshme në vijim:

- Diplomë për studime të mbaruara nga sfera e shkencave kompjuterike, teknologjive të informacionit ose sferës tjetër që ka të bëjë me ato. Studime të magjistraturës ose doktoratës nga sfera do të konsiderohet si përparësi.
- Së paku pesë (5) vjet përvojë në sferën e menaxhmetit informatik në sektorin e arsimit, me përparësi të sektorit për arsim sipëror.
- Përvojë në analizë të biznes proceseve dhe dizajnit të sistemeve komplekse informatike
- Përvojë në dizajn dhe/ose implementim të menaxhmentit informatik për arsim sipëror (EMIS) në Evropë ose rajon do të konsiderohet si përparësi.
- Njohuri për sistemin e arsimit të lartë në Maqedoni do të konsiderohet si përparësi.
- Aftësi analitike, aftësi të theksuara interpersonale dhe aftësi të mira të shkruarit dhe të komunikimit në gjuhën angleze

Konsulentët e interesuar duhet marrin parasysh pikën 1.9 të procedurave për furnizim të Bankës botërore {*Guidelines: Selection and Employment of Consultants [under IBRD Loans and IDA Credits & Grants] by World Bank Borrowers, January 2011* ("Consultant Guidelines")}, ku theksohen politikat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesave.

Konsulenti do të zgjidhet në bazë të procedurës për zgjedhje të konsulentit individual në pajtim me procedurat për furnizime të Bankës botërore ("Consultant Guidelines").

Informacionet shtesë mund të merren në adresën e shënuar më poshtë në kohën e punës prej ora 08:30 deri 16:30.

Deklaratat për interesim në gjuhën angleze (letër për shprehje të interesit, CV dhe informacione/dokumente të tjera) duhet të parashtrohen në formë me shkrim në adresën e shënuar më poshtë (personalisht, përmes postës ose me e-mail) më së voni deri më 25.06.2018.

Ministria e arsimit dhe shkencës – Projekti për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve
Për: Danijella Maneva, menaxher për furnizime (për shpallje nr. 012-18/1.1.13)
rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, 1000 Shkup
Republika e Maqedonisë
e-mail: danijela.maneva@mon.gov.mk (CC: igor.krstevski@mon.gov.mk)

---

Në bazë të nenit 50, paragrafi 1, pika 9, të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e RM nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 29 paragrafi 3 të Ligjit për kulturë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/98; 49/03; 82/05; 24/07; 116/10; 47/11; 51/11; 136/2012; 23/13; 187/13; 44/14; 61/15; 154/15, 39/16 dhe 11/18), Kryetari i Qytetit të Shkupit publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**

**për zgjedhjen e drejtorit të Institucionit publik „ Qendra kulturore për fëmijë" - Karposh – Shkup**

1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në momentin e zgjedhjes me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim ose kundërvajtje, ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- të ketë fituar më së paku 240 kredi sipas EKTS ose të ketë përfunduar shkallën VII/1të arsimit të lartë të përcaktuar me statutin e institucionit;
- ka minimum pesë vjet stazh pune në fushën e kulturës ose pesë vjet eksperiencë pune në punë ose projekte në fushën e kulturës në bazë të kontratave për punë;
- ka një nga certifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetime për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
- TOEFEL IBT – më së paku 74 pikë,
- IELTS (IELTS) - më së paku 6 pikë,
- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - më së paku nivel B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të përfunduar
- BULATS (BULATS) - më së paku 60 pikë ose
- APTIS (APTIS) - më së paku nivel B2 (B2)

2. Kandidatët janë të obliguar përveç dëshmive për plotësimin e kushteve të lartpërmendura të deponojnë edhe dokumentet e mëposhtme:
- Fletëparaqitje me biografi të shkurtër
- Dëshmi për stazh pune
- Propozim-Program për punën dhe zhvillimin e institucionit

3. Dokumentacionin e nevojshëm kandidatët janë të obliguar ta deponojnë në origjinal ose kopje të vërtetuar te noteri.
4. Afati për deponimin e dokumentacionit të nevojshëm është 7 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike në shtypin ditor.
5. Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë, i paplotë dhe i parregullt nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit. Fletëparaqitjet e shpalljes publike deponohen në adresën e mëposhtme:

**Institucioni publik „Qendra kulturore për fëmijë" Karposh – Shkup**
**Këshilli drejtues**
**(për konkursin)**
**Adresa e institucionit: bul. „Ilinden" nr.53**
**1000 Shkup. Maqedoni**

**Kryetari i Qytetit të Shkupit**

---

НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
**BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Në bazë të nenit 48 paragrafi 2, ndërsa në lidhje me nenin 49 paragrafi 3, nenit 50 dhe nenit 50-a të Ligjit për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), Banka popullore e Republikës së Maqedonisë publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**
**Për zgjedhje të dy kandidatëve për viceguvernator të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë**

1. Kandidati për viceguvernator duhet të përmbushë kriteret në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë dhe të kenë reputacion përkatës;
- Të kenë së paku arsim sipëror, 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit dhe përvojë përkatëse profesionale ose akademike në sferën e ekonomisë, financave, bankierisë ose juridikut;
- Të mos jenë borxhli në procedurë falimentimi ose likuidimi;
- Të mos u jetë shqiptuar sanksion kundërvajtjeje, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe
- Të mos u jetë shqiptuar dënim i drejtpërdrejtë ndalesë për marrje të lejes për themelim dhe punë në bankë ose institucion tjetër financiar, marrje të lejes për themelim dhe punë në bankë ose institucion tjetër financiar, ndalesë për themelim të subjektit të ri juridik dhe ndalesë të përkohshme ose të përhershme për kryerje të veprimtarisë nga sfera e financave dhe bankierisë.

2. Për përmbushjen e kritereve dhe kushteve të lartpërmendura, kandidatët së bashku me fletëparaqitjen e cila është e publikuar në internet faqen e Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë duhet të dorëzojnë:
- biografi të shkurtë në të cilën do të jepen të dhënat për përvojën e mëhershme profesionale ose akademike në sferën e ekonomisë, financave, bankierisë ose juridikut;
- vërtetim për shtetësi të dhënë nga organi kompetent i Republikës së Maqedonisë (jo më të vjetër se 6 muaj para ditës së parashtrimit të fletëparaqitjes);
- diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar sipëror, së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 të arsimit;
- deklaratë për përmbushje të kriterit nga pika 1 alineja 3 (të vërtetuar tek personi i autorizuar – noter);
- vërtetim nga organi kompetent të Republikës së Maqedonisë për sanksion jo të shqiptuar kundërvajtës, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se 6 muaj para ditës së parashtrimit të fletëparaqitjes);
-deklaratë për përmbushje të kriterit nga pika 1 alineja 5 (të vërtetuar tek personi i autorizuar – noter);

Të gjitha vërtetimet, diploma ose certifikata për arsimin e mbaruar, duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuar tek personi kompetent (noter).

3. Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 30 ditë, duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes.

4. Zgjedhja e dy kandidatëve për viceguvernator të Bankës botërore të Republikës së Maqedonisë do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

5. Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit.

6. Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen deri në Arkivin e Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë, bul. "Kuzman Josifovski Pitu" nr, 1 – Shkup.

**Banka popullore e Republikës së Maqedonisë**

# KËRCËNOHET ME JETË ARBEN TARAVARI NGA HEBIB FEJZULI



Kryebashkiaku i Gostivarit, Arben Taravari, është kërcënuar me jetë nga një person, të cilin ai e bën publi, bashkë me detajet, për të cilat jep sqarime përmes një statusi të shkruar në Facebook.

Ja reagimi i tij i plotë i tij:

“Ditën e djeshme (e shtunë) unë dhe anëtarë të familjes time jemi kërcënuar me jetë nga Hebib Fejzuli. Ky individ njihet si një person me dosje kriminale nga populli por fatkeqisht të amnestuara nga një parti shqiptaro-destruktive! Ky është njëri nga dy personat që para disa muajsh hyri i armatosur në gjimnazin e Gostivarit dhe sulmoi dy profesorë në vendin e punës së tyre.

Hebib, ti tashmë do jesh subjekt i akuzuar nga unë personalisht në organet e Drejtësisë dhe për të bërë më të njohur do të paraqes rastin tënd në çdo ambasadë, insitucion apo politikan Ndërkombëtar.

Ti nuk je vetëm një armik i imi (pasi më kërcënon), por je armik i një Gostivari të tërë duke shqetësuar qytetarët të pambrojtur nga politika!

Nuk doja të të jepja kaq rëndësi pasi në fakt ti je viktimë e një fenomeni të mbrapshtë politik-mafioz, por individë si ti janë në borxh të madh me Drejtësinë prandaj ju ka ardh koha të lajnë borxhet!

Të jeni të sigurtë që nuk tolerojmë askend që prek lirinë dhe të drejtat e qytarëve!

Është misioni ynë!”, ka shkruar Taravari.

## Familjarët gjejnë të varur djalin 14-vjeçar

Një tjetër ngjarje e rëndë raportohet të ketë ndodhur në Shqipëri. Një 14 vjeçar nga Këlcyra është gjetur i vetëvarur. Ngjarja ka ndodhur dje në orët e vona të mbrëmjes, ndërsa i mituri me iniciale E.D banues në fshatin Katundisht, Këlcyrë është dërguar i pajetë në spital. Kanë qenë familjarët ata që e gjetën 14 vjeçarin të varur në kasollen e bagëtive.

Nuk dihen shkaqet e këtij veprimi, por kohet e fundit në Shqipëri janë shtuar rastet e vetëvarjes.



## Vajza u vra nga personi që i kërkonte martesë





Xhafer Mata, 31-vjeçari nga Kukësi i mori jetën një 19-vjeçareje këtë të premte në Tiranë, pranë një kishe në zonën e Don Boskos.

Vajza me të cilën i riu kishte pasur një lidhje disa mujore, por që kishte përfunduar me dëshirën e kësaj të fundit, quhej Xhulieta Çuni, nga Vinjolli i Matit. Në kushte të rënda psikologjike ai i ka dhënë fund edhe jetës së tij. Qëlloi veten me një plumb pas koke dhe ndërroi jetë rreth një orë më pas në spitalin e Traumës. Marrëdhënia mes Xhuljetës dhe Xhaferit ka ekzistuar që prej kohës që ai ka qenë i martuar dhe ai është divorcuar me bashkëshorten me të cilën ka edhe një fëmijë 1 vjec pikërisht për shkak të 19-vjecares. Por lidhja e tyre nuk ka zgjatur më shumë se 6 muaj dhe e reja kishte kërkuar ndarjen. E këtë situatë i riu nuk e ka pranuar dot, shkruan Gazeta Telegraf. Xhafer Mata e qëlloi me 2 plumba pistolete Xhuljetën dhe pasi qendroi 15 minuta duke qare me ngasherim ne trotuar pasi e kishte vrare ish te dashuren, kaloi ne anen tjeter te rruges dhe qëlloi veten në kokë para policise qe kishte mberritur ne vendngjarje lajmeruar nga deshmitaret e shumte.

Vajza po shkonte për të dhënë sot provimin e letërsisë, pasi ishte maturante. Ajo kishte punuar per 5 muaj shitese ne nje market te zones, pune te cilen e kishte lene qe ne muajin shkurt per shkak te provimeve dhe do te kthehej aty me te mbaruar shkollen. 32 vjecari i ndërpriste rrugën çdo ditë Xhulietës, për ta bindur që ta merrte nuse në shtëpi, për të kurorëzuar kështu lidhjen intime disavjeçare.

## Boko Haram vret një shqiptar në Mali

Dyshon se sulmi është kryer nga Organizata Terroriste Boko Haram. Sipas informacioneve të siguruara nga MPJ e Kosovës, nga sy sulm terrorist ka mbetur i vrarë E.I. nga Tetova, ndërsa të plagosur, por jashtë rrezikut për jetën kanë mbetur D.M., shtetas i Republikës së Kosovës me vendbanim në Fushë-Kosovë dhe B.L., gjithashtu nga Tetova



Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Afrikë, aty ku një shqiptar është vrarë me armë zjarri gjatë grabitjes së makinës së tij.

Sipas AFP ngjarja ka ndodhur ditën e premte në Mali, shtet në Afrikën Perëndimore. Shqiptari i vrarë ishte punonjës i kompanisë “Ecolog”, nënkontraktor i Misionit të OKB-së në këtë shtet.

Sipas mediave, gjatë tentativës për të grabitur makinën ku mbeti i vdekur shqiptari, u plagosën edhe dy kolegët e tij, një kosovar dhe një maqedonas.

Në grabitjen e mbetur në tentativë, dyshohet se morën pjesë katër persona. Ngjarjen e ka konfirmuar edhe Misioni i OKB-së në Mali.

“Mëngjesin e sotëm në Gao, automjeti që furnizon me ushqime në Minusma, u sulmua nga persona të armatosur. Shoferi i automjetit u vra, kurse dy pasagjerë u plagosën dhe po marrin trajtim mjekësor në Spitalin e Minusma në Gao. Minusma dënon ashpër këtë sulm”, tha misioni i OKB-së në Twitter.

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës nëpërmjet Ambasadës së Kosovës në Senegal, ka marrë informacione se dje, në lokalitetin Gao në Mali, është kryer një sulm terrorist mbi veturën e punëtorëve të kompanisë “Ecolog”, e cila është nënkontraktuese e Misionit Paqeruajtës të OKB-së, MINUSMA.

Sipas informacioneve të siguruara nga MPJ, nga sy sulm terrorist ka mbetur i vrarë E.I. nga Tetova/Republika e Maqedonisë, ndërsa të plagosur, por jashtë rrezikut për jetën kanë mbetur D.M., shtetas i Republikës së Kosovës me vendbanim në Fushë-Kosovë dhe B.L., gjithashtu nga Tetova.

MPJ është njoftuar se të plagosurit janë në transfer e sipër për shërim në spital në Dakar/Senegal, ndërsa tashmë i ndjeri E.I. është në riatdhesim e sipër.

Ambasada e Kosovës në Senegal dhe Ambasadori Ramadan Gashi janë në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet përgjegjëse në lidhje me sigurimin e informatave se ku do të vendosën të plagosurit dhe në momentin, që të sigurohen informacione të tilla ai pritet që t'i vizitojë ata në spital.

Ministria e Punëve të Jashtme, sipas informacioneve të para të siguruara, dyshon se sulmi është kryer nga Organizata Terroriste Boko Haram.

# "Hyxhym" dost, deti u bë kos!



*Nga*
**FADIL LUSHI**

Parimisht duhet pranuar se ky shkrim nuk mund t'u dedikohet lexuesve që nuk jetojnë buzë Adriatikut, "mullirit dhe mullisit!" Unë tok me fisin dhe me mëhallën time nuk kam as Adriatikun, as "gurët e mullirit e as miellin e mullisit!" Ky farë mullisi sikur më tha: "Ty nuk të takon mielli, sepse nuk je pjesa e jonë!" Ç'është e vërteta, ne nuk e kemi detin aty pranë... dhe, lum miku, kur ti nuk e ke detin, nuk mund ta kesh as flotën detare, nuk mund ta kesh as marinën tregtare, atë të luftës, dhe, së fundi, as edhe admiralin që i jep urdhrat në gjuhën shqipe. Dikur moti, babai im më thoshte: "Biri im, 'shyqyr' që nuk e kemi detin, sepse po ta kishim, ndoshta një pjesë të tij do t'ia jepnim falas fqinjit..., njësoj si Shën Naumin dhe Vermoshin, që mbreti ynë, Ahmet Zogolli, dikur moti ia dhuroi krajlit serb!" Mandej, deti shumë vështirë vëzhgohet ,sidomos nëse atë "e shndërrojmë në kos". Ju politikanë të Shqipërisë, ju që hiqeni për superiorë, juve që hiç nuk u ha palla për hallet tona, ju që hiqeni për "aga babë", ju që keni detin, "gurët e mullirit, miellin e mullisit" dhe Karaburunin, lusim për pak kujdes dhe ndjesi..., mos harroni, edhe ne që jetojmë këtej gardhit, me shumë tamam e kemi të vërtetën tonë..., edhe ne jemi hisedar në trashëgiminë tonë të pasur kombëtare, kulturore dhe të tërat i ruajmë, i zhvillojmë dhe i pasurojmë. Nëse ju në vaktin e Enverit kishit dhe keni spitalin psikiatrik të Elbasanit a edhe të Vlorës, edhe ne kemi çmendinën e Bardovcës dhe Demir Hisarit. Nëse ju në vaktin e diktatorit tuaj kishit Burrelin dhe Spaçin, ne në kohën e diktatorit tonë të egër e fashist kishim më shumë kazamate, atë në Petrova Rupa të Goli Otokut, Zabelën e Pozharevcit, Idrizovën, Dubravën e Kosovës e tjerë..., ani se nuk kishim e nuk kemi det... Andej, nga ju, ata që hiqnin të zitë e ullirit, me gardianët flisnin shqip, këtej nga ne llafoseshin maqedonisht dhe në gjuhën serbokroate. E gjithë kjo nuk ishte dhe nuk është njësoj, sepse ne këtejpari e donim edhe Shqipërinë edhe lirinë tonë të munguar! Ju e donit vetëm Shqipërinë! Vërtetë nuk ishte njësoj, andaj mos thoni se ishte ashtu siç keni thënë, sepse nëse vazhdoni të na bindni se ishte njësoj, atëherë do të na përjashtoni nga e drejta jonë e të qenit hisedar! Ju lusim, pushoni njëherë e përgjithmonë të na thoni: "Neve na vjen keq, por ama, ne nuk kemi kohë për ju, kemi hallet dhe shqetësimet tona!" Edhe përtej kësaj mospërfilljeje, ne asnjëherë nuk "do ta mallkojmë e as do ta mohojmë vetveten dhe vendin ku jetojmë!", ani se, nuk e kemi Adriatikun, "gurët e mullirit, mullisin dhe miellin e tij!"

Ju politikanë dhe akademikë të shtetit amë! Edhe ne këtej gardhit kemi kuzhinën politike. Është pak orientale e pak oksidentale, me orientim pak nga lindja e pak nga perëndimi..., as mish as peshk..., ani se nuk e kemi Adriatikun, "gurët e mullirit dhe miellin e mullisit!" Ne këtej kufirit administrativ, kemi "tepsinë e madhe prej bakri", "kjo tepsia jonë" është më e "pasur" se juaja..., ne e kemi të mbushur me lloj-lloj "zarzavatesh të importuara" nga Turqia, nga Serbia, Bullgaria, nga Greqia, nga Brukselli, nga Moska dhe fare pak nga ju! Edhe ju keni "tepsinë" tuaj, por ama nuk është si jona! Dhe kjo nuk është njësoj! Ju politikanë të shtetit amë! Edhe ne kemi "kazanin" mediatik, politik dhe atë të drejtësisë, ku sot e gjithë ditën e Perëndisë, shqiptarëve me pa të drejtë u shqiptohen dënime drakoniane a kapitale! Edhe kjo nuk është njësoj! Ky "kazani" ynë, në krahasim me tuajin, është prej "teneqeje" dhe me bojë të verdhë! Ne shpesh detyrohemi "kazanin" ta çojmë te "ustai" për t'ia "mbyllur vrimat". Ky "ustai" e vonon qëllimisht riparimin. Ndodh që edhe të mos na e kthejë "kazanin që nuk është toptan pronë jona!" Ky "kazan i përngjan enëlarëses" ku shpëlahen trutë e shqiptarëve dhe ca pakica njerëzish të tjerë. Edhe kjo nuk është njësoj..., andaj mos thoni se është ashtu! Edhe ne dikur kishim "aga babën" tonë dhe, që kur ishte i ri, qe i mençur, ishte namuzqar, nuk është si këta të sotmit, ky "aga baba" hiç fare nuk i kishte për qejf thashethemet! He, he, "terbijen" e kishte me tamam prej shehërliu..., "terbije" prej aristokrati dhe prej pashai, njësoj si..., dhe kjo nuk është njësoj si te ne, si te ju! Ne këtej Qafë Thanës, kemi masturbuesit patriotë, masturbuesit intelektualë dhe militantët patriotikë. Politikanët tuaj që hiqen si "djathtistë", masturbimin e "bëjnë brenda në çadër", ndërkaq "majtistët" vetëkënaqen te fushat ku kultivohet ajo bima barishtore njëvjeçare, që kur e konsumon, ta bën mendjen "livadh!" Edhe kjo nuk është njësoj! Edhe ne këtej kufirit administrativ kemi njerëz të rrjedhur nga fiqiri, por ama jo deri në atë derexhe që ju pretendoni të thoni. Sa për kosin, ne gjithandej e kemi me bollëk, qoftë ai kos dhensh, dhish, lopësh e tjerë..., edhe ne kemi fqinjët ortodoks, por ama prej tyre nuk kërkojmë "FARË KOSI për ta shndërruar detin në kos!". Nuk e bëjmë dot, sepse nuk e kemi Adriatikun, "gurët e mullirit dhe miellin e mullisit!" Edhe kjo nuk është njësoj, edhe përtej dëshirës sonë a suajës për të (mos) qenë ndryshe!

> **I nderuar Kryeministër, para se ta krijosh Shqipërinë Natyrale, bëj kujdes dhe merre parasysh edhe inatin tonë dhe të shqiptarëve nga Kosova..., ki parasysh të vërtetën se ne këtej gardhit nuk pëlqejmë ta "hamë" byrekun me "presh"..., ne nuk e mbajmë lugën në brez..., në do ta bësh Shqipërinë e Nënës, atëherë hiq mënjanë kleptomanët që zhvatin xhepat e miletit. Në do ta bësh këtë, atëherë do jetë krejt NJËSOJ, si për ne ashtu edhe për ju! Ndryshe nuk bën**

Zoti kryeministër, para se ta bësh "Shqipërinë e Madhe" apo atë natyralen, bëj kujdes se si do të duket ajo. I respektuar dhe shumë i nderuar kryeministër! Në do ta bësh Shqipërinë Natyrale, ki kujdes se si do të duket qeveria e saj, bëj kujdes si do quhet kuvendi. Do të quhet me emrin e vjetër Kuvendi Popullor, do të thirret me emrin aktual Kuvend i Shqipërisë-

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS




Koha
E përditshme informative
www.koha.mk
Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi
Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 10 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
**E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222** | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup
NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

njëdhomësh, me 140 deputetë, ose, në istancë të fundit, do të emërtohet KUVENDI MBARKOMBËTAR i shqiptarëve!? I çmuari kryeministër, pa na thuaj sa deputetë do të kesh nga Maqedonia, Kosova e Lugina..., pa na thuaj, a do të na marrësh vetëm si numër a si pjesë e shartuar dhe jo e natyrshme e trungut të familjes mëmë! Ne duam të të besojmë se nuk do të na paragjykosh dhe nuk do të na marrësh si fëmijë prej njerke! Edhe ne këtej kufirit shqiptaro-shqiptar kemi burra mendjendritur edhe për shtëpi edhe për çarshi, edhe për mexhlise edhe për politikë, edhe për Evropë, edhe për Amerikë, edhe për..., ani se në Tetovë, në Shkup, në Prizren e Prishtinë, në Preshevë, nuk e kemi detin, "gurët e mullirit dhe miellin e mullisit!" I nderuari kryeministër, para se ta bësh Shqipërinë Natyrale besoj se do të kesh kujdes edhe për ligjin themelor të "dovletit të ri". I nderuar Kryeministër, para se të krijosh Shqipërinë Natyrale, bëj kujdes dhe merre parasysh edhe inatin tonë dhe të shqiptarëve nga Kosova..., ki parasysh të vërtetën se ne këtej gardhit nuk pëlqejmë ta "hamë" byrekun me "presh"..., ne nuk e mbajmë lugën në brez..., në do ta bësh Shqipërinë e Nënës, atëherë hiq mënjanë kleptomanët që zhvatin xhepat e miletit. Në do ta bësh këtë, atëherë do jetë krejt NJËSOJ, si për ne ashtu edhe për ju! Ndryshe nuk bën.

# Pyetje për Merkelin



Nga
Jens THURAU

Dikur, para ca kohe, në një nga mbledhjet e grupit parlamentar unionist Angela Merkel thuhet se e shprehu dakordimin e saj. "Nëse duhet patjetër, atëherë le ta bëjmë". Shumë parlamentarë të të gjitha grupeve parlamentare kishte kohë që kishin kërkuar që t'i zëvendësonin pyetjet e thata ndaj qeverisë prej përfaqësuesve të popullit, gjithmonë të mërkurave në çdo javë seancash parlamentare, me një spektakël të vërtetë me kryetaren e pranishme të qeverisë. Të paktën tri herë në vit. Sepse deri tani, me vite të tëra, përgjigje për pyetjet e komplikuara kanë dhënë sekretarët e shtetit nga ministritë.

Por në vizitat në botën e jashtme, si për shembull në Britaninë e Madhe dhe në Spanjë deputetët e Bundestagut patën përjetuar sa të gjalla mund të jenë orët e pyetjeve me kryetarët e qeverisë. Dhe tani, pas premierës në Gjermani mund të thuash: ata kishin të drejtë, ia vlejti.

Ia vlejti edhe për Angela Merkelin. Pse druhej kancelarja nga kjo marrje në pyetje? E sigurtë në fakte dhe pa iu dredhur qerpiku iu përgjigj ajo pyetjeve për raportin me Rusinë, për Donald Trumpin, për Kinën, për skandalin me Zyrën Federale për Refugjatët. Dhe natyrisht, kjo është bërë tashmë e zakonshme në Bundestag, populistët e djathtë të Alternativës për Gjermaninë shkumëzuan dhe provokuan pa fund. Merkeli ka shkaktuar një përmbytje me migrantë, ka asgjësuar miliarda, kur ka ndër mend të japë dorëheqjen?



Kancelarja iu përgjigj për herë të parë pyetjeve të deputetëve të Bundestagut. Dhe u përgjigj tepër e qetë, duke nxjerrë në pah përvojën, e sigurtë në fakte. Pse e kishte kundërshtuar ajo më parë këtë?

Bën pjesë pa dyshim në virtytet e mëdha të kancelares që e humbet rrallë kontrollin, kjo u konfirmua edhe këtë herë. Në vend të kësaj, ajo e shfrytëzoi rastin për të shprehur falenderime për mijëra punonjësit e Zyrës Federale të Migrimit. Kështu veprohet, kur do ta lësh që të vejë huq kundërshtari politik. Dhe: kancelarja e shfrytëzoi orën e pyetjeve për disa pozicionime shumë të qarta. A nuk do ta përfshijë ajo Rusinë sërish në grupin e shteteve të mëdha të industrializuara, pra që grupin G7 ta bëjë sërish G8? Në asnjë mënyrë, sepse "aneksimi i Krimesë ishte një shkelje flagrante e së drejtës ndërkombëtare". Prandaj përjashtimi i Rusisë është i drejtë, tha kancelarja. Pikë.

Mirë për Merkelin ishte edhe që partneri i saj i koalicionit, socialdemokratët i rezistoi tundimit që tensionet e krijuara në aleancën qeveritare t'i shkarkonin në seancën e pyetjeve për Merkelin. Socialdemokratët bënë pyetje të sjellshme specifike, këtu mund të ishin treguar edhe më të ashpër, për shembull duke bërë pyetjen se sa bashkëpërgjegjësi mban Merkeli për kushtet e këqia në Zyrën Federale për Migrimin, bashkëpërgjegjëse ajo me siguri që është. Por kjo pyetje nuk u dëgjua. Si përfundim: Po të ketë pasur ndonjëherë frikë nga kjo marrje në pyetje Merkeli, nga "pjekja në skarë" siç shkruan disa gazeta, atëherë mund të thuash se frika ka qenë pa bazë. Po të vazhdojë gjithmonë kështu, Merkeli me siguri që do të shkojë me dëshirë për ta pyetur. Dhe fare në fund ajo i la të pranishmit të shijonin pak humorin e saj të qetë, të cilin përndryshe e njohin vetëm njerëz shumë pranë me të: "Sado keq që të vjen, ja që e gjitha mbaroi. Po do të vij prapë", iu drejtua ajo sallës. Epo atëherë...

# Shqipëria, drogat dhe përgjimet

Nga Riccardo CELEGHINI




Ngjarjet, ku përfshiheshin dy figura kyçe të Partisë Socialiste (PS), nxitën sulmin e opozitës, të udhëhequr nga Partia Demokratike (PD), e cila doli në rrugë për të kërkuar dorëheqjen e Kryeministrit Edi Rama. Dinamikat gjyqësore, politike dhe mediatike rreth të dy rasteve nuk janë shumë të qarta, por ajo që është e sigurt është se rikrijimi i një ndërhyrjeje të rrezikshme mes politikës dhe krimit, si dhe një klimë tensionesh midis forcave politike, hedh një hije mbi vendin në javët vendimtare për të marrë dritën e gjelbër për hapjen e negociatave të pranimit me Bashkimin Evropian.

Në javët e fundit, ministri aktual i brendshëm, Fatmir Xhafaj, arkitekt i reformave të mëdha të drejtësisë, përfundoi në qendër të një skandali. Në fillim të majit, Partia Demokratike ka bërë publik një vendim të një gjykate italiane, të vitit 2002, kur vëllai i ministrit u dënua me shtatë vjet burg për "bashkëpunim kriminal me qëllim trafikimin e drogës", një vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë e Kasacionit në vitin 2012. Një ditë më vonë, po PD-ja lëshoi përgjime të tjera, nga e cila dukej se vëllai i ministrit, ka qëndruar në Shqipëri për t'i shpëtuar dënimit në Itali, ai ende vazhdonte të ishte i angazhuar në trafiqet e paligjshme dhe marrëdhëniet kriminale. Opozita gjithashtu akuzon ministrin se ka mbrojtur vëllain e tij, duke modifikuar një ligj ekstradimi të për të lehtësuar qëndrimin e tij në Shqipëri. Akuzat janë përgënjeshtruar nga ana e Ministrit të Brendshëm dhe Partisë Socialiste: sipas kryeministrit Rama, kjo është një vepër e falsifikuar e ndërtuar për të dëmtuar qeverinë dhe imazhin e jashtëm të Shqipërisë. Megjithatë, fushata e ndërmarrë nga opozita është shumë vendimtare.

Më 24 maj, kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka zënë podiumin e parlamentit për të nisur sharjet e tij, para se të gjithë deputetët e opozitës të largoheshin nga salla e kuvendit, duke refuzuar votimin e një mocioni e cila mbështeste aderimin evropian të vendit. Disa ditë më vonë ajo u pasua nga një demonstratë e cila kërkonte dorëheqjen e Xhafaj dhe Ramës. Ajo është në fakt vazhdimi i strategjisë së "murit kundër murit" të kryer nga PD-ja vitet e fundit, nën drejtimin e liderit të vjetër të partisë, Kryeministrit dhe Presidentit të Shqipërisë, për pjesën më të madhe të viteve '90 dhe në vitin 2000, Sali Berisha. Çështja është veçanërisht e nxehtë dhe pritet të ketë të reja. Janë jo pak analistë që flasin për një fushatë të hartuar për të hedhur në erë karrigen e ministrit, autor i reformave të guximshme. Dyshimet vijnë edhe për kohën e fushatës opozitës: pse tani janë vënë në lëvizje audiot dhe dokumentet në lidhje me ngjarjet e shumë viteve më parë? (zëri.info)

Dy skandale në lidhje me trafikimin e drogës kanë goditur nivelet më të larta të politikës shqiptare. Ashtu si ish-ministri i Brendshëm përfundon nën arrest shtëpiak, pasardhësi i tij është në sy të stuhisë për një rast gjyqësor që përfshin vëllain e tij

### Të gjithë të njohin si legjendë, por unë si baba

Gramozi, njëri nga fëmijët e ish-kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, njeriut më meritor për pranimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare të futbollit FIFA dhe UEFA, ka shkruar se Vokrri i kishte mësuar atij shumë gjëra më rëndësi në jetë. Ai thotë se i ka shumë borxh ish-sulmuesit të Prishtinës, Partizanit dhe shumë skuadrave tjera. "Të gjithë të njohin si legjendë, por unë të njoh si baba, si njeriun që më mësoi gjëra më rëndësi në jetë: respekt, humanizëm dhe punë. Të kam aq shumë borxh! Pusho në paqe baba legjendar!", ka shkruar në statusin e tij ë Facebook, Gramozi.



# KOSOVA NË ZI, IU DHA LAMTUMIRA E FUNDIT FADIL VOKRRIT

**Qindra qytetarë, sportistë, politikanë e zyrtarë të UEFA-s kanë marrë pjesë në homazhet për Fadil Vokrrin, i cili të shtunën pas një sulmi në zemër, ka ndërruar jetë**



Një lajm i zi për futbollin shqiptar, në përgjithësi dhe atë kosovar në veçanti. Presidenti i FFK-së (Federatës Kosovare të Futbollit), Fadil Vokrri, 57 vjeç, të shtunën ka ndërruar jetë. Rezultatet e autopsisë së trupit të pajetë të Vokrrit, të publikuara dje, kanë konfirmuar se ai ka vdekur nga sulmi në zemër. Lajmin e kanë konfirmuar fillimisht familjarët e legjendës të futbollit kosovar. Ai ishte dërguar me urgjencë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, pasi i është rënduar gjendja shëndetësore, pas një sulmi në zemër. Menjëherë është dërguar në spital, por situata ka ardhur duke u përkeqësuar dhe ai ka ndërruar jetë.

**NGUSHËLLIMET PËR VDEKJEN E KRYETARIT TË FFK-së**

Ashtu siç ishte paralajmëruar, të dielën në ora 12:00 filluan homazhet për ikonën e futbollit kosovar që ndërroi jetë të shtunën, Fadil Vokrrin. Vdekja e Vokrrit tronditi mbarë opinionin shqiptar, sidomos sektin futbolldashës. Shprehu ngushëllimet për humbjen e parakohshme të Vokrrit edhe presidenti i FSHF-së, Armand Duka, i cili theksoi se Fadili me veprat e tij do të mbetet i përjetshëm. "Në fakt, nuk e mendoja se do të isha në këtë ditë për të folur për këtë gjë. Nuk e mendoja se do të vija në Prishtinë për të përcjellë Fadilin. Për mua ai është futbollisti më i madh në Shqipëri. Unë kam humbur një mik dhe nuk po e them vetëm si një fjalë rasti. E kam menduar si të pabesueshëm dhe lajm të rremë, por ja që isha gabuar. Ai nuk e njihte diplomacinë dhe ta thoshte të vërtetën në sy. Për këtë mendoj se kemi humbur shumë. Ka humbur i gjithë sporti një njeri të mrekullueshëm", tha Duka.

Ish-trajneri i Shqipërisë, Xhanni De Biasi, është bashkuar me dhimbjen për humbjen e legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrrit. "Me dhimbjen më të madhe po përjetoj edhe lajmin për ndarjen e parakohshme nga jeta të mikut tim Fadil Vokrri,. Vetëm pak ditë më parë u takuam në Cyrih dhe pamë ndeshjen bashkë. Më duket e pabesueshme që ai nuk është më fizikisht mes nesh. Lamtumirë Fadil! U prehsh në paqe!", shkroi De Biasi.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, bëri homazhe pranë arkivolit të trupit të pajetë të Fadil Vokrrit. Pas homazheve, kryeministri Haradinaj, në librin e zisë shkroi "Fadil ishe i të gjithë neve, të gjithë të nderojmë". Edhe kryetari i Kuvendit të Maqedonisë Talat Xhaferi dhe i Bashkimit Demokratik për Integrim Ali Ahmeti, kanë shprehur ngushëllimet për vdekjen e kryetarit të FFK-së, Fadil Vokrri.

"E parakohshme fishkëllima e fundit, por fitorja jote është e siguruar dhe e vulosur që moti. Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës", shkroi Ahmeti. "Sot me pikëllim mora lajmin e ndarjes nga jeta të një njeriu të shtrenjtë, njeriut që ngriti në nivelet më të larta sportin (Futbollin), njëkohësisht i palodhshëm për çështjen kombëtare. Karizmatik pafund ishte padyshim, Fadil Vokrri. Më lejoni që në këto momente plot dhimbje, ti shpreh në emrin tim personal dhe në emër të familjes sime, ngushëllimet më të sinqerta familjes Vokrri dhe miqve të tij, ngushëllime gjithë qytetarëve të Kosovës. Ndajmë dhimbjen me ju, durim në këto çaste të vështira. I paharruar do të mbetet kujtimi për te", ka shkruar në postimin e tij Talat Xhaferi. Legjenda kroate e futbollit, Zvonimir Boban e ka vlerësuar tejet lartë Fadil Vokrrin. Pas homazheve ai tha se Vokrri ka qenë njeri i madh. "Erdha për ta ngushëlluar familjen e Vokrrit për këtë humbje të madhe me vdekjen e tij. Normalisht që sjellë ngushëllime nga Çeferin. Ka qenë legjendë e futbollit. Më rrallë jam takuar viteve të fundit, por ka qenë njeri i madh. Shpresoj se do të takohemi në një botë tjetër, për të luajtur futboll", tha Boban. Futbollisti i përfaqësueses së Kosovës, Valon Berisha, pasi ka bërë homazhe për legjendën e futbollit kosovar, Fadil Vokrri, ka qenë tejet i pikëlluar. "Ka qenë një lajm shumë i keq dhe shumë i papritur, Vokrri ishte një njeri i madh edhe idhull për gjeneratat e reja. Unë po ndihem shumë keq sepse e kam njohur edhe nga afër. Pa të nuk do të ishim sot këtu, çka ka bërë ai për neve nuk bën të harrohet kurrë, për shtetin dhe për futbollin. E falënderoj për atë se çfarë ka bërë për Kosovën dhe për mua", shkroi Berisha. Fadil Vokrri u varros dje në Prishtinë. Mensur Nexhipi dhe Rafet Prekazi, dy ish-futbollistët e gjeneratës së artë të KF Prishtina (vitet e 80-ta), kanë mbetur pa fjalë pas lajmit të kobshëm për vdekjen e bashkëlojtarit të tyre, Fadil Vokrri. "Pusho në paqe i madhi Fadil Vokrri! Ngushëllime familjes dhe miqve", ka shkruar Nexhipi. "Ngushëllime futbollit kosovar, prehu në paqe Miku im", është postimi i Rafet Prekazit.

Ndërkohë, gazeta KOHA, i shpreh ngushëllimet më të thella familjes së tij Fadil Vokrrit, Federatës Kosovare të Futbollit dhe gjithë miqve e dashamirësve të futbollit. Ai do të mbetet në histori jo vetëm për talentin dhe karrierën si futbollist, por si presidenti i parë i FFK-së, që mundësoi anëtarësimin e futbollit kosovar në FIFA dhe UEFA. Shteti më i ri i Ballkanit, falë punës së tij këmbëngulëse, garon sot në garat ndërkombëtare.

**KUSH ISHTE FADIL VOKRRI**

Fadil Vokrri u lind më 23 korrik të vitit 1960 në Podujevë. Me futboll nisi të merret si 15-vjeçar, kurse si 17-vjeçar debutoi në KF "Llapi" në Podujevë. Më pas në vitin 1980 kaloi tek KF Prishtina, ku luajti 84 ndeshje dhe shënoi 33 gola me këtë skuadër në Ligën e Dytë, kurse në Ligën e Parë të Jugosllavisë në fanellën e Prishtinës pati 88 paraqitje dhe realizoi 22 gola. Periudha e viteve të 80-ta ishte e artë për Vokrrin, i cili në vitin 1984 debutoi në ekipin përfaqësues të Jugosllavisë, duke u bërë futbollisti i vetëm shqiptar që u paraqit në Përfaqësuese, e ku regjistroi 12 paraqitje dhe shënoi 6 gola. Në vitin 1986 u transferua te Partizani i Beogradit ku në 27 ndeshje shënoi 13 gola. Ai me meritë e fitoi epitetin e legjendës së futbollit kosovar, pasi ishte bartës i flamurit olimpik në Lojërat Olimpike Dimërore në Sarajevë në vitin 1984, derisa në vitin 1987 ishte shpallur lojtari më i mirë në Jugosllavi. Në vitin 1989 kaloi në Francë te skuadra Nimes dhe më pas u transferua në klubin turk, Fenerbahçe ku luajti me mjaft sukses në edicionet 1990-1992. Pas karrierës në kampionatin turk ai u rikthye në Francë ku jetoi me familjen dhe luajti edhe për disa vjet për skuadrat e niveleve më të ulëta franceze, Bourges dhe Montluçon, para se t'i jepte fund karrierës.

Pas çlirimit të Kosovës, ai, u kthye në atdhe, fillimisht për ta ndihmuar ish-klubin e tij, Prishtina, në postin e drejtorit, kurse më pas në shkurt të vitit 2008 e mori timonin e Federatës së Futbollit të Kosovës si njeriu më i duhur për ta drejtuar FFK-në drejt anëtarësimit në UEFA e FIFA. Më 15 janar, 2016, Vokrrit iu besua mandati i tretë katërvjeçar si kryetar i FFK-së. Ai ishte i diplomuar në Fakultetin e Menaxhmentit dhe Biznesit, kurse përveç gjuhës amtare zotëronte edhe gjuhët frënge, turke dhe serbokroate. Ai la pas bashkëshorten Editën dhe tre fëmijët, djemtë Gramozin e Albertin dhe vajzën Albanën.






Ka zgjatur vetëm katër raunde ndeshja e Sefer Seferit, kundër kampionit të botës në peshat e rënda në boks, Tajson Fury. Stafi i boksierit shqiptar vendosi që ta tërheqë atë nga ringu, me pretendimin se ishte i dëmtuar, kur kishin kaluar vetëm 4 raunde. Natyrisht që ishte një sfidë ku nuk priteshin surpriza, pasi britaniku kishte një peshë trupore më tepër se 20 kg më të madhe se Sefer Seferi

# SEFERI REZISTON VETËM KATËR RAUNDE NDAJ FURYT

Boksieri britanik Tajson Fury, ish-kampion bote në peshën e rëndë, ka fituar me "KO" në raundin e katërt ndaj shqiptarit Sefer Seferi, një duel me 10 raunde zhvilluar në Mançester. Kjo ishte sfida e parë pas më shumë se dy vitesh e gjysmë pushim për Fury, që rikthehet në ring me misionin për të rimarrë titujt kampionë. Dhe në këtë rinisje të aventurës, britaniku nuk zhgënjeu, duke korrur fitoren e 26-të në karrierën e tij (asnjë humbje), ndërsa Seferi pësoi humbjen e dytë (ka edhe 23 fitore). Një duel midis Davidit dhe Golias, por këtë herë nuk pati surpriza, pasi Fury fitoi pa djersitur shumë ndaj Seferit. Për gati tri raunde, dueli është më shumë qesharak, pa shumë aksion dhe emocione, pasi Fury mendon më shumë të argëtojë fansat me veprimet e tij se sa të boksojë, siç është edhe puthja që i dha në buzë Seferit para se të niste dueli. Ndërkohë që, sfida më e bukur duket jashtë ringut, ku ka edhe rrëmujë mes turmës që ndodhet afër ringut, që tërheq edhe vëmendjen e boksierëve. Seferi tenton hera-herës të sulmojë Furyn, por është më i shkurtër dhe Fury e mban mirë larg vetes, duke kontrolluar duelin dhe lëshuar ndonjë grusht të fortë, ndërkohë që gjyqtari i fton të jenë më agresivë në ring. Në raundin e katërt Fury nis të jetë më agresiv me grushtet e tij dhe vë në vështirësi Seferin. Edhe pse ky raund mbyllet dhe bëhet gati të nisë raundi i pestë, boksieri shqiptar vendos që të mos rikthehet më në ring, pasi nuk është më në gjendje të duelojë dhe përballojë ritmin e forcën e Fury (u përfol se Seferi është dëmtuar). Gjyqtari ndal ndeshjen dhe Fury fiton me "KO" në raundin e katërt, duke korrur kështu suksesin e parë pas 28 muajsh pushimi. "Mu duk sikur debutova edhe një herë në ring. Nuk është faji im që ai u dëmtua. Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen. Të tjera sfida të mëdha më presin", tha Fury.

## Alimi kuqezi deri në vitin 2021

Shkup, 10 qershor - Mesfushori Armend Alimi ka vazhduar bashkëpunimin me skuadeën e Shkëndijës, duke firmosur kontratë të re me kohëzgjatje për dy vite plus një tjetër shtesë", bëri të ditur klubi kuqezi, transmeton gazeta KOHA. Klubi dhe lojtari gjetën akordin për marrëveshje të re dhe 30-të vjeçari nga Kumanova vazhdon qëndrimin në Tetovë ku katër sezonet e kaluara u konfirmua një prej futbollistëve më të rëndësishëm të ekipit. Cekim, Alimi te Shkëndija erdhi verën e vitit 2014 pasi paraprakisht kishte luajtur në kampionatet elitare në Qipro, Norvegji dhe Kroaci. Në katër sezonet e kaluara me kuqezinjtë ishte ndër futbollistët më standard. Ai ka zhvilluar 120 paraqitje kampionale në të cilat ka realizuar 25 gola, ndërsa ishte pjesë e skuadrës që fitoi tre trofe (1 kampionat dhe 2 Kupa). Me mbajtjen e një prej mesfushorët më të mirë në vend në skuadër, Shkëndija garanton siguri në mesfushë edhe për periudhën që pason.




## Smajlaj në superformë, "vishet" sërish në ar

Izmir Smajlaj rrëmbeu një tjetër medalje ari duke u shpallur kampion në kërcim së gjati në Evropianin e shteteve të vogla. Në garën e zhvilluar këtë të shtunë në Lihtenshtain, Smajlaj arriti të regjistrojë rezultatin më të mirë mes 12 konkurrentëve duke u konfirmuar në një formë shumë të mirë fizike e duke treguar dhe njëherë nivelin e tij të lartë. Smajlaj kërceu 7 metra e 90 centimetra duke kërcyer 23 centimetra më tepër se rivali i tij i vendit të dytë që ishte gjeorgjiani Lasha Gulelauri. Të gjithë kërcimet e realizuara me sukses nga atleti shkodran ishin më të mira se rivali i tij i vendit të dytë, ndërkohë që për një faull milimetrik nuk arriti të vendosë dhe një rekord të ri




me 8 metra e 20 centimetra. Fitorja në këtë kampionat të vendeve të vogla është treguesi i formës së mirë të Smajlajt dhe në prag të Evropianit të Atletikës që do të zhvillohet nga 7 deri më 12 gusht në Berlin të Gjermanisë.

S'BËN PJESË NË PLANET E TRAJNERIT

## Levante nxjerr në shitje Sadikun

Armando Sadiku nuk mund të gjejë vend në sulmin e Levantes për sezonin e ardhshëm, ndaj duhet të kërkojë një destinacion të ri. Kështu shkruan prestigjiozja spanjolle "Marca" në lidhje me situatën e sulmuesit të Kombëtares Shqiptare, që u transferuar në janar nga Legia e Varshavës te skuadra valenciane. Në analizën e "Marca"-s shkruhet se trajneri Pako Lopez ka një plan për sulmin, por në këtë plan nuk bën pjesë Sadiku, ndaj klubi spanjoll është i gatshëm të dëgjojë ofertat për të. Boateng dhe Rogjer janë dy elementët kryesorë të repartit të avancuar ku do të mbështetet trajneri, ndërkohë që kërkohen dhe dy sulmues cilësorë në merkato. Sadiku, që ka firmosur një kontratë të vlefshme deri në vitin 2020 e ka të qartë situatën ku ndodhet, ndaj klubi kërkon ta largojë ose duke e shitur, ose në formë huazimi. Të ardhmen e Sadikut do ta vendosin ofertat që do të vijnë te Levante për kartonin e tij. Sigurisht nëse nuk ofrohet shuma e duhur, sulmuesi mund të qëndrojë, por qëllimi kryesor i Levantes është të gjejë blerës për të.



# JUVENTUSI I OFRON PSZH-së SULMUESIN ARGJENTINAS



Skuadra e PSZH-së është e kënaqur nga ky transferim, pasi është në kërkim të një sulmuesi që të zëvendësojë Edinson Kavani, por mbi të gjitha Dybala pëlqehet shumë nga trajneri i ri Tuçel. Dybala ka një kontratë me Juventusin e cila skadon në vitin 2022 dhe vështirë se kjo lëvizje mund të ndodhë

Një lajm i ardhur nga Franca ka trembur tifozët bardhezinj. Sipas të përditshmes "Paris United", një gazetë afër skuadrës së Paris Sen Zhermen, skuadra e Juventusit i ka ofruar ekipit kampion të Francës sulmuesin Paulo Dybala. Jo vetëm kaq, por vëllai i sulmuesit ka disa kohë që ndodhet në Paris në kërkim të një sistemi të ri. Skuadra e PSZH-së është e kënaqur nga ky transferim, pasi është në kërkim të një sulmuesi që të zëvendësojë Edinson Kavani, por mbi të gjitha Dybala pëlqehet shumë nga trajneri i ri Tuçel.

Dybala ka një kontratë me Juventusin e cila skadon në vitin 2022 dhe vështirë se kjo lëvizje mund të ndodhë, ndërkohë që PSZH pret një përgjigje nga FIFA në lidhje me "fair play financiar", pasi bëhet fjalë për një transferim që do t'i kushtojë shumë kampionëve të Francës. Por duket se edhe vetë sulmuesi është i kënaqur nga kjo lëvizje, pasi Dybala i ka kërkuar familjes që të largohen nga Torino këtë verë, për në Madrid, destinacioni Real ose në Paris. Duket se Parisi është vendi ideal për Dybala, ku do të luante gjithnjë, do të fitonte më shumë dhe trajneri Tuçel kërkon një futbollist me cilësi të mira teknike. Në ndihmë te skuadrës parisienë është edhe ish-drejtori sportiv i Palermës, Luca Kattani, që tashmë ndodhet në Paris, njeriu që solli për herë të parë Dybala në Evropë, në vitin 2012 dhe që po bën ndërmjetësin në këtë transferim.

## Deulofeu arrin marrëveshje me Vatfordin

Skuadrat e Vatford dhe Barcelona kanë arritur një marrëveshje në lidhje me të ardhmen e sulmuesit spanjoll Xherard Deulofeu. Sulmuesi 24-vjeçar, që në fazën e dytë të sezonit të kaluar ka luajtur në formë huazimi te skuadra briktanike, tashmë do të jetë 100% i ekipit anglez. Në janar, Deulefeu kaloi në formë huazimi tek Vatford, ku luajti vetëm 7 ndeshje dhe realizoi një gol. Por nga dita e sotme kartoni i lojtarit i përket skuadrës së Premier Ligë, që ka paguar 13 milionë euro, plus bonuse të ndryshme, për të marrë sulmuesin 24-vjeçar. Marrëveshja do të zyrtarizohet javën e ardhshme, por duket se Deulefeu nuk bënte më pjesë në planet e trajnerit Pelegrino, që e la të lirë të largohet. Kjo është hera e tretë që sulmuesi luan në Premier Ligë, pasi ka veshur më parë edhe fanellën e Evertonit, në dy periudha të ndryshme.



BEJLL REFUZON BAJERNIN DHE REALIN

## Dua të rikthehem në Premier Ligë



Geret Bejll i ka mbyllur derën transferimit te skuadra e Bajern Munih, duke u thënë kampionëve të Gjermanisë se synon që të rikthehet në Premier Ligë në rast se do të largohet nga Real Madridi. Kampionët e Gjermanisë e konsideronin Bejll si zëvendësuesin ideal të veteranëve Frank Riberi apo Arjen Robben, por uellsiani duket se preferon më mirë rikthimin në Premier se sa të luajë në Bundesligë. Trajneri i ri i Bajernit, Niko Kovaç, i kishte bërë një ofertë lojtarit të "merengues", që dy javë më parë i dha fitoren skuadrës së Realit në finalen e "Champions League". Por sulmuesi uellsian ia ka bërë të qartë drejtuesve të Realit se në rast ata vendosin ta largojnë, t'i gjejnë një ekip në Premier Ligë, ku ka luajtur edhe më parë. Dhe ofertat nga Anglia nuk kanë munguar për 28-vjeçarin, me Mançester Junajted që mbetet në "pole" për ta marrë. Por, kudo që të shkojë për të luajtur, për Bejll problemi më i madh mbetet çmimi, pasi Reali kërkon rreth 100 milionë euro për sulmuesin. Me skuadrën e Real Madridit, sulmuesi uellsian nuk aktivizohet shumë, madje edhe në finalen e Çampions e nisi takimin nga stoli, por në fund realizoi dy gola.

SIPAS GAZETËS "MARCA"

## Nejmar në Real, palët bien dakord



Real Madrid është gati të shpenzojë 350 milionë euro për të siguruar shërbimet e Nejmar. Braziliani është kthyer në një fiksim për presidentin Florentino Perez, i cili është gati të bëjë gjithçka për ta marrë. Tani, "Marca" ka zbuluar se disa përfaqësues të madrilenëve janë takuar javën e kaluar me Nejmarin në Liverpul (aty është luajtura miqësorja Brazil-Kroaci). Takimi është mbyllur me sukses, me ishyllin e Barcelonës që ka shprehur dëshirën e tij për t'u transferuar në "Santiago Bernabeu". Madje, ai ka siguruar se është i gatshëm të rrisë presionin ndaj drejtuesve të Paris Sen-Zhermenn që të pranojnë ofertën e Real Madridit.

## Reali me shifër rekord për të marrë Milinkoviç-Saviç



Real Madrid ka bërë ofertën e çmendur të 150 milionë eurove për të marrë mesfushorin serb të Lacio, Sergej Milinkoviç-Saviç, një sinjal i qartë se skuadra "merengues" e kërkon me çdo kusht lojtarin dhe se asnjë rival nuk mund t'i afrohet kësaj shifre. Lojtari ka shumë admirues, në Serinë A dhe jashtë saj, në Spanjë dhe Angli, por skuadra e Real duket se ka vënë veton me këtë ofertë, që duket e parezistueshme. Nga ky transferim, Milinkoviç-Saviç do të përfitojë 6 milionë euro në sezon. Drejtuesit e Real janë gati të plotësojnë kërkesën e presidentit të Lacios, Klaudio Lotito, ndaj kanë bërë ofertën marramendëse edhe pse asnjë drejtues nga klubi italian nuk e konfirmon këtë. Por, kjo shumë është edhe për të mundur konkurrencën e madhe që është për Milinkoviç-Saviç, që me shumë gjasa do të fanellë tjetër sezonin e ardhshëm. Duket se për serbin ka nisur një ankand, me skuadrën "merengues" që duket në "pole" për ta marrë, duke mundur edhe konkurrencën e Juventusit.




PËR
PAGESË

EVN ONLINE SHËRBIME

E-FATURA
- Pranim në kohë dhe në mënyrë të sigurtë të faturave të energjisë elektrike
- Regjistrim online i shpejtë dhe i thjeshtë
- Mirupafshim rrëmujës së letrave në shtëpi

ONLINE PAGESA
- Pagesë e shpejtë dhe e sigurt pa komision pagese
- Pagesë e shpejtë pa pritje para sporteleve
- Pasqyrimi i borxhit të përgjithshëm ndaj EVN-së Regjistrim online i shpejtë dhe i thjeshtë
- Regjistrim të më shumë njehsorëve në një profil konsumatori
- Regjistrim i shpejtë i pagesave

PAGESË E SHPEJTË
- Pa regjistrim të profilit të konsumatorit
- Pagesë e lehtë, e shpejtë dhe e sigurt

- Shpejtë
- Lehtë
- Sigurt

www.evnonline.mk
EVN


Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/2015), Drejtori i SHFK "Todor Janev" Çashka publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE**
**Për punësim të personelit administrativ për kohë të pacaktuar të punës për vendin e punës në vijim**

Sekretar me orar të plotë të punës 40 (dyzet) orë pune në javë, pagesa bazë 20.985,00 denarë.
1 realizues

Orari ditor i punës është 8 (tetë) ditë edhe atë prej ora 07:00 deri në ora 15:00. Orari javor i punës me orar të plotë të punës është 40 orë të shpërndara në 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte.
Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune edhe atë:
-të kenë arsim përkatës të nevojshëm për vendin e punës (arsim sipëror shkencat ekonomike-juridike)
-të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë

Së bashku me fletëparaqitje për punësim duhet të parashtrohen dokumentet në vijim edhe atë:
-Dëftesa për arsim të mbaruar përkatës
-Certifikatë të shtetësisë
Dokumentet parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.
Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit në shtypin ditor.
Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen në adresën SHFK "Todor Janev" – Çashka, rr. 8-mi Septemvri nr. 1 – Çashka.

Drejtor
/Violeta Spirkovski/






Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/23, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 167/15 dhe 15/16), nenit 142, 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18), Pëlqimit të Ministrisë së financave të RM nr. 18-5253/2 të datës 29.05.2018 dhe nr. 18-6242/2 të datës 29.05.2018, Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "MAJSKI CVET" Karposh – Shkup nr. 01-104 të datës 25.06.2015

**IPKÇF "MAJSKI CVET" Karposh – Shkup**
**publikon**
**SHPALLJE PUBLIKE nr. 03/2018**
për punësim për kohë të pacaktuar

- **PËRKËDHELËS............................................................... 1 (një) realizues**
  - Arsim të mesëm të mbaruar 4 (katër) vjeçar,
  - Licencë valide për përkëdhelës,
  - Me ose pa përvojë pune.
  - Orari ditor i punës: 8 (tetë) orë, i shkallëzuar (prej ora 06-00 deri ora 14-00, prej ora 07-00 deri ora 15-00, prej ora 08-00 deri ora 16-00, prej ora 09-00 deri ora 17-00 dhe prej ora 10-00 deri ora 18-00).
